

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA JAUPI kundër SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 23369/16)

VENDIM

Neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) (aspekti penal) • Seancë dëgjimore e drejtë • Mbrojtja me prezencë • Gjykimi dhe dënimi i kërkuarit *in absentia* për vrasje dhe vrasje të mbetur në tentativë për të cilën u dënua me burgim të përjetshëm • Mosndjekja nga vetë kërkuari i seancës në apel, pas rivendosjes në afat të periudhës së ankimit, edhe pse e kishte këtë mundësi, dhe për rrjedhojë mospërdorimi i plotë i të gjitha mjeteve të parashikuara në legjislacionin e brendshëm • Kërkuari përgjegjës për situatën për të cilën ankohet

Neni 6 §§ 1 dhe 3 (d) (aspekti penal) • Seancë dëgjimore e drejtë • Pyetja e dëshmitarëve • Pamundësia e kërkuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës • Arsye të forta për mospraninë e dëshmitarëve • Dëshmi pa peshë të konsiderueshme nga dëshmitari i akuzës dhe as prova e vetme as vendimtare në lidhje me dënimin e kërkuarit për vrasje • Të drejtat e mbrojtjes të pakufizuara në masë të papajtueshme me garancitë e nenit 6 në lidhje me dënimin për vrasje • Faktorë të pamjaftueshëm për të kundërbalancuar disavantazhet e mbrojtjes që rrjedhin nga mungesa e pranisë së dëshmitarit të akuzës, dëshmia e të cilit është vendimtare për dënimin e kërkuarit për vrasje të mbetur në tentativë

Përgatitur nga Zyra e Kancelarit. Nuk është i detyrueshëm për Gjykatën.

STRASBURG

29 prill 2025

Ky vendim do të bëhet përfundimtar në rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit të Konventës. Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Jaupi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:
Ioannis Ktistakis, *kryetar*,

Lətif Hüseyinov,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir,

Diana Kovatcheva,

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit*,

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 23369/16) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) nga një shtetas shqiptar, z. Kastriot Jaupi (“kërkuari”), më 22 prill 2016;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) për ankimet në lidhje me të drejtën e kërkuarit për të marrë pjesë në procese penale kundër tij, për të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës,

për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme dhe që gjykatat e brendshme të japin arsye të mjaftueshme në vendimet dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 18 mars 2025,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me gjykimin e kërkuarit *in absentia* për vrasje të mbetur në tentativë dhe vrasje për të cilën ai u dënua me burgim të përjetshëm.

FAKTET

2. Kërkuari ka lindur në vitin 1975 dhe po vuan dënimin me burg. Ai u përfaqësua nga z. Sh. Syri, avokat i licencuar në Berat.

3. Qeveria u përfaqësua nga Agjentja e asaj kohe znj. A. Hicka dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbledhen si më poshtë.

I. SFONDI I ÇËSHTJES

5. Në vitin 1997, vëllai i kërkuarit, I. J., u plagos gjatë ndërhyrjes së policisë në rrethin e Beratit gjatë kohës së trazirave civile që ndodhën pas rënies së skemave të përhapura piramidale. Ai u dërgua në spital ku më pas vdiq nga plagët e marra.

6. Më 7 shtator 2000, rreth orës 6:30 të mëngjesit, u bë një tentativë për të vrarë I. N., shefin e Policisë Kriminale të Beratit dhe shoferin e tij A. J. në Qafën e Koshovicës, në rrethin e Fierit.

7. Më 30 dhjetor 2000, rreth orës 11:00 I. N. u vra në një lokal afër shtëpisë së tij në Vlorë.

II. HETIMI

8. Më 7 shtator 2000, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier filloi hetimin kundër kërkuarit me dyshimin për vrasje të mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J., e cila kishin ndodhur më herët po atë ditë në Qafën e Koshovicës, në rrethin Fier (shihni paragrafin 6 më sipër).

9. Po atë ditë, I. N. deklaroi para një oficeri të policisë gjyqësore të Prokurorisë së Fierit. Ai tha se mëngjesin e asaj dite kishte qenë në një makinë që drejtohej nga shoferi i tij, A. J. Ai ishte ulur në sediljen e pasagjerit përpara dhe po flinte. Një e shtënë arme në shpatullën e majtë e zgjoi dhe e kuptoi që ishte plagosur. Dëgjoi të shtëna automatiku që zgjatën rreth dhjetë deri në pesëmbëdhjetë sekonda. I tha shoferit të vazhdonte të ngiste makinën. Pas pak kohe, ata ndaluan në Fier dhe I. N. telefonoi policinë. I. N. tha se nuk e kishte parë personin që i kishte sulmuar sepse kishte qenë në gjumë dhe kur u zgjua gjithçka kishte ndodhur shumë shpejt. Ai nuk kishte parë asnjë automjet të parkuar në vendin ku pati të shtëna dhe as ndonjë automjet që t'i ndiqte ose t'i parakalonte.

I. N. tha gjithashtu se rreth njëzet ditë më parë kishte qenë duke drejtuar makinën e tij dhe ishte afruar pranë një makine tjetër të parkuar në mes të rrugës dhe i kishte rënë borisë që shoferi të largohej dhe më pas kishte vënë re se shoferi kishte qenë kërkuari. Kërkuari e kishte kaluar me makinë dhe ishte larguar nga zona. I. N. kishte njoftuar Komisaratin e Policisë për atë incident, por kërkuari nuk ishte kapur. Të nesërmen, kur I. N. ishte në zyrën e tij, u informua se nëna e kërkuarit, L. J., donte ta takonte. Ai nuk e priti, dhe ajo u kthye të nesërmen, kur ai e takoi në zyrën e tij. Ajo i tha që I. N. që ai i kishte vrarë djalën (shihni paragrafin 5 më lart) dhe që donte t'i vriste edhe djalën tjetër. Ajo gjithashtu i tha I. N. "ne do të të vrasim". Pas kësaj, I. N. e largoi nga zyra e tij. Dy ditë më pas, një inspektor policie, E. Ll., i kishte thënë I. N. se kishte mësuar nga një informator i besuar se kërkuari kishte përgatitur një sulm ndaj I. N. dhe se kishte hetuar për rutinën e tij të përditshme. I. N. ia kishte përcjellë këtë informacion Shefit të Komisarimit dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit. I. N. tha se bazuar në këto fakte, për mendimin e tij, kërkuari ishte personi që kishte organizuar tentativën për ta vrarë.

10. Më 23 nëntor 2000, B. H. u mor në pyetje nga policia gjyqësore. Ai tha se në shtator 2000 kishte qenë në Greqi. Një ditë, ndoshta më 20 shtator 2000, rreth orës 12:30 të pasdites, ai e kishte takuar kërkuesin, të cilin e njohte, në stacionin e autobusëve “Akademi” në Athinë, ku ishte ulur në pritje të autobusit. B. H. i kishte thënë kërkuesit se e njohte vëllanë e tij, I. J., dhe se ata [familja e kërkuesit] kishin shumë armiq në Shqipëri. Kërkuesi i ishte përgjigjur se kishte bërë edhe një armik tjetër, sepse disa ditë më parë kishte qëlluar një oficer policie, Shefin e Komisarariatit të Beratit, I. N., në Qafën e Koshovicës, sepse I. N. kishte vrarë vëllanë e tij [të kërkuesit]. Fillimisht kërkuesi kishte menduar se e kishte qëlluar për vdekje I. N., por më vonë kishte mësuar se I. N. kishte mbijetuar. Gjithashtu kërkuesi i tha B. H. se e dinte që policia ishte në kërkim të tij.

B. H. i tha gjithashtu policisë se e njohte shumë mirë I. N. sepse ai kishte punuar për policinë. Pas bisedës së tij me kërkuesin, B. H. i kishte telefonuar I. N. dhe i kishte thënë se personi që e kishte qëlluar ndodhej në Greqi.

11. Më 30 dhjetor 2000, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë filloi hetimin kundër kërkuesit me dyshimin për vrasjen e I. N. më herët po atë ditë në Vlorë (shihni paragrafin 7 më sipër).

12. Gjatë hetimit u mbledhën provat e mëposhtme: raporti i vendit të ngjarjes, procesverbali i këqyrjes së trupit të viktimës, raporti i autopsisë dhe aktet e ekspertizës për armën dhe fishekun e përdorur, të gjitha të shoqëruara me fotografi.

13. Më 30 dhjetor 2000, policia intervistoi A. L. dhe A. Ç.

14. A. L. tha se po atë ditë, rreth orës 11:00, kishte parë një burrë duke vrapuar përgjatë një rruge me shtëpi që ndodhej paralel me rrugën Vlorë-Skelë në Vlorë. Në dorë mbante një pistoletë të zezë. Ishte duke vrapuar drejt shkollës “Ismail Qemali” dhe kaloi në një distancë prej 3–4 metrash larg A. L. Ai ishte me lëkurë të errët, me gjatësi mesatare, mbipeshë, me flokë të shkurtër të zinj. Burri ishte ndalur për t’i folur një personi me initiale A. Ç. dhe e kishte pyetur si ishte, dhe A. Ç. i ishte përgjigjur “Mirë”. A. L. kishte parë gjithashtu një polic, B. T., duke vrapuar, por kishte humbur gjurmët e burrit me lëkurë të errët. A. L. kishte parë gjithashtu tre civilë të tjerë duke vrapuar pas policit. A. L. tha se e kishte parë burrin që kishte vrapuar me pistoletë në dorë vetëm nga mbrapa dhe nuk do të ishte në gjendje ta njohte.

15. A. Ç. tha se atë ditë mes orës 10:30 dhe 11:00, ai kishte parë gjithashtu, në një distancë prej rreth pesë metrash, një burrë që vinte nga Rruga Kinoteatri. Ecte shpejt dhe mbante një armë me dorezë të bardhë dhe tytë të zezë. Kur pa armën, A. Ç. hyri në një ndërtesë. Nga aty ai pa burrin duke u larguar në drejtim të shkollës Ismail Qemali në rrugën kryesore. A. Ç. e përshkroi burrin si 175 cm të gjatë, me trup të fuqishëm, me fytyrë disi të errët, të rruar pastër dhe me flokë të errët e të drejtë të krehur në njërën anë. A. Ç. tha se do ta njohte po ta shikonte. Policia i tregoi A. Ç. fotografitë e tetë personave. Ai e identifikoi kërkuesin, Kastriot Jaupi, si personin që kishte takuar në rrugë.

16. Më 31 dhjetor 2000, policia mori në pyetje R. B. dhe I. Zh.

17. R. B. tha se jetonte në Vlorë dhe se në gusht të atij viti kishte qenë në Tiranë me A. K., i cili ishte nga Fieri. Ndërsa ishin ulur në një restorant në Tiranë, A. K. e thirri dikë me emrin “Joti”. Joti erdhi në tavolinën e tyre me një person tjetër. Pas atij takimi, R. B. e kishte takuar Jotin në lokalin Mercedes në Fier. Ata ishin bërë miq dhe kalonin shumë kohë bashkë. R. B. kishte mësuar nga Joti se emri i tij i vërtetë ishte Kastriot Jaupi, se kishte qenë shumë kohë në Itali, se ishte akuzuar për vrasje që kishin ndodhur në Berat, por ishte liruar “sepse kishte shumë miq”. Kastrioti i kishte thënë R. B. se vëllai i tij ishte vrarë dhe se kishte mësuar nga miqtë e tij policë që kishin marrë pjesë në operacionin ku ishte vrarë vëllai i tij se atë e kishte vrarë I. N. Kastrioti i kishte thënë R. B. se do të merrte hak për vëllanë e tij dhe do të vriste I. N. pavarësisht pasojave. Rreth një javë pas vrasjes të mbetur në tentativë të I. N. në Qafën e Koshovicës më 7 shtator 2000, Kastrioti i kishte thënë R. B. se e kishte bërë ai, kishte përshkruar pritën dhe të shtënat në drejtim të makinës me detaje dhe kishte shprehur zhgënjimin që nuk kishte pasur sukses. Kastrioti kishte folur për këto ngjarje me lehtësi.

Në mes të nëntorit 2000, Kastrioti e kishte prezantuar R. B. me një person të quajtur Shuaip, duke e prezantuar atë si një mik të ngushtë të tij që nga fëmijëria. Shuaipi kishte lëkurë më të errët, flokë të errët, më i shkurtër se Kastrioti, por me trup më të fuqishëm.

Herët në mëngjesin e datës 30 dhjetor 2000, Kastrioti e kishte telefonuar R. B.-në dhe i kishte kërkuar të takohet me të në shkollën e mesme “Halim Xhelo”.

Kur mbërriti R. B., ai pa se bashkë me Kastriotin ishte edhe Shuaipi. Kastrioti i kërkoi R. B.-së t’u jepte hua makinën e tij për të “mbaruar disa punë” dhe R. B. pranoi. R. B. pa Kastriotin të ulur në sediljen e shoferit dhe Shuaipin në sediljen e pasagjerit përpara. Të dy kishin veshur rroba sportive. Kastrioti kishte veshur tuta gri dhe të zeza me një bluzë të zezë poshtë tyre dhe atlete të bardha, dhe Shuaipi kishte veshur tuta blu me një bluzë të bardhë poshtë dhe atlete të bardha.

Kastrioti i tha R. B.-së se do ta linte makinën në shtëpinë e R. B.-së. Kur R. B. u kthye në shtëpi rreth orës 11:00, ai pa makinën e tij të parkuar atje. Pastaj ai kishte shkuar për pazar me gruan e tij dhe kur u kthyen, policia kishte ardhur në shtëpinë e tyre dhe i kishte thënë R. B. të mos ta prekte makinën sepse ishte përdorur për një vrasje. Policia e shoqëroi R. B. në rajonin e policisë dhe atje ai mësoi se I. N. ishte vrarë.

18. I. Zh., i cili kishte një vëlla të quajtur D. Zh., tha se nofka e D. Zh. ishte Shuaip. Ai tha se dy muaj më parë D. Zh. kishte telefonuar vëllanë tjetër, Z. Zh., i cili jetonte së bashku me I. Zh. dhe anëtarë të tjerë të familjes. Pasi kishte folur me D. Zh., Z. Zh. i kishte thënë I. Zh.-së se D. Zh. i kishte thënë se në kohën e vrasjes ai kishte qenë në Fier me kërkuesin.

19. Më 8 janar 2001, S. M., Sh. O. dhe Shp. O. u morën në pyetje nga policia gjyqësore në kuadër të hetimit të tyre.

20. S. M. tha se më 30 dhjetor 2000 kishte parë dy persona, një të bardhë dhe një me origjinë rome, që qëndronin në oborrin e shtëpisë së B. M. në Levan, Fier, së bashku me djemtë e B. M. Personi me origjinë rome iu drejtua S. M. dhe e pyeti nga ishte, dhe i tha se quhej Shuaip. S. M. tha gjithashtu se mund t’i njihte ata dy persona.

Policia i tregoi S. M.-së. fotografitë e tetë personave. Ai e njohu D. Zh. dhe kërkuesin si personat që kishte parë më 30 dhjetor 2000 në shtëpinë e B. M. në një fshat pranë Qafës së Koshovicës.

21. Sh. O. tha se jetonte në fshatin Levan në rrethin e Fierit. B. M. ishte motra e babait të tij dhe jetonte në të njëjtin fshat. Më 5 janar 2001, Sh. O. kishte shkuar në shtëpinë e saj, ku kishte parë dy burra që nuk i njihte. B. M. i kishte thënë Sh. O. se ata ishin nga Berati, por nuk i kishte treguar emrat e tyre. Të nesërmen, më 6 janar 2001, Sh. O. i kishte parë përsëri në oborrin e shtëpisë së B. M. Njëri nga burrat ishte me origjinë rome, me trup mesatar, me flokë të zinj të krehur prapa. Burri tjetër ishte i bardhë, gjithashtu me trup mesatar, por më i dobët se burri tjetër. Vëllai i Sh. O.-së, Xh. O., i kishte thënë Sh. O.-së se burri me origjinë rome ishte vëllai i një personi të quajtur Zamir nga Berati, i cili ishte martuar me tezen e Sh. O.-së, S. Burri tjetër ishte shok i vëllait të Zamirit. Sh. O. tha se të dy burrat kishin qëndruar në shtëpinë e B. M.-së për disa ditë. Ai nuk i kishte parë ata pas 7 janarit 2001. Ai tha se B. M. duhet t’i ketë njohur ata që kur kishin qëndruar në shtëpinë e saj.

22. Shp. O., djali i B. M., tha se më 1 janar 2001 kishte parë dy burra në shtëpinë e nënës së tij. Ajo i kishte thënë se ishin nga Berati. Shp. O. kishte njohur njërin prej burrave, një burrë me origjinë rome, si Shuaipin, kunatin e S. nga Berati. Burri tjetër, që Shp. O. nuk e njihte, ishte i bardhë. Shp. O. i kishte parë përsëri kur kishte vizituar shtëpinë e mamasë së tij më 3 janar 2001. Ai kishte folur me ta dhe ata kishin thënë se kishin qenë në Itali dhe do të donin të shkonin përsëri.

23. Më 9 janar 2001, policia i tregoi Sh. O.-së fotografitë e tetë personave. Ai i identifikoi edhe D. Zh. edhe kërkuesin si persona që kishte parë në shtëpinë e B. M. më 5 dhe 6 janar 2001.

24. Më 11 janar 2001, policia mori në pyetje B. M. Ajo tha se jetonte në fshatin Levan në rrethin e Fierit. Mbrëmjen e 31 dhjetorit 2000, dy burra, të cilët nuk i njihte, kishin shkuar në shtëpinë e saj. B.

M. tha se në atë kohë, burri i saj Q., vajzat e saj So. dhe Sa., djali i saj Shp., me gruan e tij D., dhe djali tjetër, F., kishin qenë gjithashtu në shtëpinë e saj.

Një nga burrat, me orgjinë rome, i kishte thënë se ishte kunati i motrës së saj S., e cila jetonte në Berat, që do të thotë se ai ishte vëllai i Zamirit, burrit të motrës së B. M. Ai tha se sapo kishin mbërritur në Vlorë, pasi kishin ardhur me motoskaf nga Italia, kishin marrë me qira një makinë dhe kishin shkuar në Levan natën, kështu që kishin kërkuar të kalonin natën në shtëpinë e saj. Burri tjetër ishte i bardhë.

B. M. tha se nuk kishte parë që ata kishin telefona celularë ose ndonjë armë. Burrat kishin dalë nga shtëpia e saj në këmbë më 1 janar 2001 dhe ishin drejtuar në drejtim të fshatit Levan.

25. Më 15 janar 2001, policia i tregoi B. T.-së, një dëshmitar okular i sulmit me armë (shihni paragrafin 35 më poshtë), fotografi të tetë personave. Ai e identifikoi D. Zh. si personin që kishte qëlluar I. N.-në për vdekje.

26. Më 15 shkurt 2001, Th. N., babai i I. N.-së, u mor në pyetje nga prokurori. Ai tha se djali i tij, I. N., ishte paralajmëruar se do të vritej. Vrasësit ishin vëllezërit Jaupi nga Berati, që kishin vepruar vetëm ose me persona të tjerë. Ai e dinte për vrasjen e djalit të tij pranë shtëpisë nga ajo që i kishte thënë më parë djali i tij.

Motivi për vrasjen e djalit të tij lidhej me kryerjen e detyrave të tij si polic dhe me vrasjen e vëllait të kërkuesit në vitin 1997 gjatë një ndërhyrjeje policore (shihni paragrafin 5 më sipër). Pas kësaj, I. N. kishte filluar të merrte kërcënime nga familja Jaupi.

Në vitin 1998, vëllezërit Jaupi e kishin ftuar I. N. për drekë në Urën Vajguore, pranë aeroportit, por ai e kishte refuzuar ftesën. Pasi I. N. ishte caktuar me detyrë në Policinë e Beratit, ai i tha Th. N. se vëllezërit Jaupi, E. dhe Kastriot, kishin plane për ta vrarë dhe se kishin paguar njerëz të caktuar për ta ndjekur kur ai të shkonte nga Vlora në Berat. Th. N. tha se I. N. e dinte se ata do t'i bënë pritë dhe do ta vrisnin diku jashtë Beratit. Shqetësimet e tij ishin rritur çdo ditë disa ditë para vdekjes së tij.

Lidhur me tentativën për vrasjen e djalit të tij më 7 shtator 2000 rreth orës 6:30 të mëngjesit në Qafën e Koshovicës, ishte komentuar publikisht se pas kësaj tentative ishin vëllezërit Jaupi. Pas kësaj, djali i tij kishte kërkuar transferim, dhe i kishte paraqitur shqetësimin e tij Ministrit të Brendshëm.

Për një farë kohe, I. N. ishte emëruar në Komisariatën e Policisë së Delvinës si shef i Policisë. I. N. kishte mësuar shpejt se kërkuesi e kishte organizuar vrasjen e tij diku përgjatë *Rrugës së Bregut*. Th. N. tha gjithashtu se djali i tij i kishte thënë se ishte larguar nga detyra me urdhër të ministrit të Brendshëm dhe kështu ishte lënë pa asnjë mbrojtje.

Në fillim të dhjetorit 2000, një person i panjohur kishte telefonuar në shtëpinë e I. N. dhe i kishte thënë gruas së I. N., e cila ishte përgjigjur në telefon, se I. N. do të vritej “sapo të dilte nga shtëpia e tij”.

Më 26 dhjetor 2000, I. N. ishte takuar me Bi. M., drejtorin e Policisë së Shtetit, i cili i kishte thënë se nuk mund të vendosej diku tjetër sepse ishte larguar nga detyra dhe se Ministri i Brendshëm më parë kishte menduar ta dërgonte në Itali.

Më 29 dhjetor 2000, I. N. kishte qenë seriozisht i shqetësuar për jetën e tij dhe kishte menduar se do të vritej pranë shtëpisë së tij. Sipas Th. N., djali i tij ishte kërcënuar.

27. Më 28 nëntor 2001, kërkuesi u arrestua në Spanjë sipas një urdhër-arresti ndërkombëtar të lëshuar më 27 tetor 2000 nga Gjykata e Rrethit të Beratit në lidhje me akuzat për vrasjen e një personi të quajtur Sh. T. në vitin 1997 dhe armëmbajtje pa leje, dhe një urdhër-arresti tjetër ndërkombëtar të lëshuar më 12 janar 2001 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Vlorës për vrasjen e I. N. Kërkuesit iu dorëzua urdhër-arresti që përmbante akuzat e ngritura kundër tij. Kërkuesi e kundërshtoi kërkesën për ekstradimin e tij në Shqipëri në gjykatat spanjolle (shihni paragrafin 43 më poshtë). Gjykata Kushtetuese Spanjolle prishi vendimin e gjykatave më të ulëta për ekstradimin e kërkuesit, për arsye procedurale. Në këto procese, avokati i kërkuesit paraqiti si provë një kopje të përkthyer të vendimit

të Gjykatës së Rrethit Vlorë të datës 4 korrik 2003, sipas të cilit kërkuesi ishte dënuar *in absentia* për vrasjen e I. N. Duket se ndërsa këto procese ishin akoma duke u zhvilluar, një kërkesë ishte në pritje për ekstradimin e kërkuesit në Itali me dyshimin e vrasjes të mbetur në tentativë të kryer në Itali.

28. Më 27 korrik 2002, hetimi për vrasjen e mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J. u bashkua me atë të vrasjes së I. N.

III. PROCEDURA PËR AKTAKUZËN

29. Më 24 shtator 2002, Prokuroria e Vlorës ngriti akuzën ndaj kërkuesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë për vrasje të mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J. më 7 shtator 2000 në Qafën e Koshovicës dhe vrasje të I. N. më 30 dhjetor 2000 në Vlorë, sipas nenit 79 (c) në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.

30. Gjyqi filloi më 27 dhjetor 2002 dhe u mbajt në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në mungesë të kërkuesit, sepse ai ishte i ndaluar në Spanjë, pas arrestimit me kërkesë të autoriteteve shqiptare në lidhje me procesin penal. Ai u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga familja e tij. Avokati kërkoi që gjyqi të shtyhej derisa kërkuesi të informohej për gjyqin, por gjykata e shkallës së parë e refuzoi kërkesën.

31. Gjatë gjyqit, dëshmitarët E. Ll., B. T., A. L., E. B. dhe L. J. dhanë deklarin e tyre. Dëshmitarët A. J., A. Ç, B. M., Sh. O. dhe S. M. nuk u paraqitën në procesin gjyqësor. Deklarimet që ata kishin dhënë në polici u lexuan në gjykatën e shkallës së parë. Në një seancë dëgjimore më 26 maj 2003, A. L. dha deklarin e tij (shihni paragrafin 14 më sipër).

32. Në një seancë dëgjimore më 18 qershor 2003, nëna e kërkuesit, L. J., tha se policia, përkatësisht oficeri I. N., kishte vrarë djalin e saj I. J. Ajo theksoi se jo vetëm që I. N. e kishte vrarë djalin e saj, por ai kishte ngacmuar familjen e saj dhe kishte “hyrë në gjakmarrje” me ta. Për shkak të kësaj ai duhej të vdiste, sepse “gjaku mund të lahet vetëm me gjak” dhe për këtë arsye djali i saj, kërkuesi, kishte filluar të “ngatërrohej” me I. N.

33. Në një seancë dëgjimore të mbajtur më 25 shkurt 2003, dëshmitarët E. B. dhe B. T. dhanë dëshminë e tyre.

34. E. B., një kamerier në lokalin ku u vra I. N., tha se më 30 dhjetor 2000, rreth orës 10 të mëngjesit, I. N. kishte qenë në lokal duke pirë kafe kur një burrë ishte shfaqur pas tij dhe kishte qëlluar disa herë drejt tij nga një distancë rreth katër pesë metra. I. N. ishte përkulur dhe kishte rënë në tokë. Personi i armatosur mbante një pistoletë me të dyja duart. Ai kishte veshur tuta me kapuç në kokë, ishte mbipeshë dhe me gjatësi mesatare. E. B. nuk e kishte parë mirë fytyrën e tij dhe tha se nuk do ta njohte nëse do ta shihte. Pas të shtënave, personi i armatosur ishte larguar në drejtim të qendrës tregtare.

35. B. T., një polic i cili në atë moment nuk ishte në detyrë dhe ishte me uniformë civile, tha se më 30 dhjetor 2000 kishte qenë duke pirë kafe me I. N. te Bar Shelgu në rrugën “Skelë” në Vlorë. I. N. ishte ulur me shpinën e kthyer nga rruga. Pas disa çastesh, B. T. kishte dëgjuar zhurmë dhe mendoi se ishin fishekzjarre. I. N. ishte ngritur në këmbë, kishte kapur rripin, ishte përkulur dhe kishte rënë përtokë. B. T. kishte dëgjuar tre deri në katër të shtëna. Ai kishte parë një burrë të veshur me rroba të zeza, disi mbipeshë, me fytyrë të errët, i cili kishte qëlluar drejt I. N. nga një distancë prej rreth tre deri në katër metra. B. T. kishte filluar të vraponte pas tij.

B. T. kishte telefonuar policinë me radio dhe kishte raportuar vrasjen e I. N. ndërsa ndiqte autorin e krimit.

Ai kishte parë gjithashtu një burrë tjetër duke ikur me vrap me autorin e krimit. B. T. i kishte parë të dy në profil nga e djathta.

Gjykata e Rrethit i dha B. T. një kopje të deklarin e tij që ai kishte dhënë në polici. Avokati i kërkuesit e kundërshtoi.

Pasi lexoi deklarinimin që ai kishte dhënë më parë, B. T. tha se personi i armatosur kishte veshur bluzë të zezë dhe kishte flokë të shkurtër dhe disi kaçurrela. Ai tha se do ta njihte personin e armatosur dhe personin që kishte qenë me të.

Në përgjigje të një pyetjeje nga kryesuesi i trupit gjykues, B. T. tha se personi i armatosur ishte 1.70 deri në 1.75 metra i gjatë.

36. Në një seancë dëgjimore më 12 mars 2003, prokurori raportoi se disa përpjekje për t'i dorëzuar fletëthirrjen dëshmitarit R. B. në adresën e tij të shtëpisë kishin dështuar dhe se i vetmi informacion që kishin për vendndodhjen e tij ishte që ai ndodhej jashtë shtetit. Avokati i kërkuesit kërkoi që R. B. të thirrej përsëri. Gjykata e Rrethit urdhëroi që ai të sillej në gjyq nga policia gjyqësore, por ai nuk mund të gjendej.

37. Në një seancë dëgjimore të mbajtur më 27 mars 2003, dëshmitarët R. B., A. J., B. H., A. Ç., Sh. O., B. M. dhe Sh. M. nuk u paraqitën. Prokurori raportoi se sipas informacionit nga policia gjyqësore, ata ishin të gjithë jashtë shtetit në vendndodhje të panjohura dhe kishin dështuar përpjekjet për t'i thirrur. Prandaj, Gjykata e Rrethit vendosi të lexonte deklarinimet që ata kishin dhënë në polici gjatë hetimit. Avokati i kërkuesit e kundërshtoi. Ai tha se policia kishte ushtruar presion mbi dëshmitarin B. M.

Pasi u lexuan deklarinimet e dëshmitarëve, avokati i kërkuesit tha se ato ishin kontradiktore dhe jo të vërteta dhe se këta dëshmitarë ishin analfabetë.

38. Gjykata dërgoi fletëthirrje te dëshmitarët B. H., S. M., I. Zh. dhe Z. Zh., por ato nuk u dorëzuan. Gjykata e Rrethit urdhëroi që ata të silleshin në gjykatë nga policia, por ata nuk u gjetën. Ata nuk u paraqitën në seancën dëgjimore të mbajtur më 8 maj 2003. Prokurori tha se policia gjyqësore kishte raportuar më 23 prill 2003 se policia kishte kontrolluar adresat e të gjithë dëshmitarëve dhe kishte mësuar se B. H. kishte emigruar në Greqi dhe se dëshmitarët e tjerë kishin shkuar jashtë shtetit, pa detaje të mëtejshme.

Prandaj, Gjykata e Rrethit vendosi të lexonte deklarinimet që B. H. dhe I. Zh. kishin dhënë në polici gjatë hetimit (shihni paragrafët 10 dhe 18 më sipër).

Pasi u lexuan deklarinimet e dëshmitarëve, avokati i kërkuesit tha se deklarimi i B. H. ishte i sajuar dhe se ato të I. Zh. dhe Z. Zh. ishin të pavlefshme sepse nuk ishin bërë në përputhje me ligjin, duke pasur parasysh se I. Zh. dhe Z. Zh. ishin analfabetë dhe nuk i kishin nënshkruar deklarinimet e tyre.

39. Në një seancë dëgjimore më 26 maj 2003, Gjykata e Rrethit të Vlorës përcaktoi që dëshmitari Th. N. ndodhej në Rusi për trajtim mjekësor, dhe për këtë arsye u lexua deklarimi që ai i kishte bërë prokurorit gjatë hetimit (shihni paragrafin 26 më sipër).

40. Në një seancë dëgjimore më 4 qershor 2003, dëshmitari E. Ll., një polic, dha dëshminë e tij. Ai tha se kishte qenë në Komisaratin e Policisë së Beratit midis 2 majit 1999 dhe 20 qershorit 2001. I. N. kishte qenë atje si shef i Policisë Kriminale. Një person i panjohur e kishte telefonuar E. Ll. në gusht 2000 dhe e kishte paralajmëruar të mos i afrohej shumë I. N. sepse I. N. do të vritej. E. Ll. kishte pyetur se kush kishte folur, dhe përgjigjja kishte qenë se E. Ll. i kishte bërë një nder dhe se paralajmërimi ishte dhënë për t'ia kthyer nderin E. Ll. Pasi E. Ll. këmbënguli që ai të zbulonte identitetin e tij, folësi kishte thënë se familja Jaupi po planifikonte të vriste I. N. për shkak të një "problemi të vjetër".

Pas disa ditësh, E. Ll. e kishte informuar I. N. për atë bisedë.

I. N. i kishte thënë E. Ll. se kishte qenë në shtëpinë e kërkuesit, ku kishte takuar nënën dhe motrën e kërkuesit dhe burrin e motrës së tij dhe u kishte thënë atyre: "Nëse doni të më vrisni, bëjeni tani. Unë jam në shtëpinë tuaj dhe i paarmatosur."

Pas disa ditësh, i njëjti person e kishte telefonuar përsëri E. Ll. dhe i kishte thënë se vizita e I. N. në shtëpinë e kërkuesit kishte qenë lëvizje e gabuar.

E. Ll. tha se një të diel I. N. ishte nisur drejt Vlorës. Të nesërmen, E. Ll. ishte urdhëruar të shkonte në Fier sepse ndaj I. N. ishte kryer një sulm në Qafën e Koshovicës. Po atë mbrëmje, i njëjti person e kishte telefonuar përsëri E. Ll. dhe i kishte thënë të kishte kujdes. Pas atij sulmi, të gjithë në Komisariatit e Policisë së Beratit i kishin thënë I. N. të largohej nga Berati.

Në përgjigje të një pyetjeje nga prokurori, E. Ll. shpjegoi se “problemi i vjetër” që ai kishte përmendur ishte vrasja e vëllait të kërkuesit në vitin 1997.

Ndërsa një pyetjeje tjetër nga prokurori, E. Ll. iu përgjigj se I. N. i kishte thënë se nuk e kishte parë personin që kishte qëlluar mbi të më 7 shtator 2000.

41. Më 4 korrik 2003, Gjykata e Rrethit të Vlorës e dënoi kërkuesin sipas akuzës dhe e dënoi me burgim të përjetshëm.

Lidhur me motivin e kërkuesit, Gjykata e Rrethit gjeti që vëllai i kërkuesit, I. J., ishte plagosur rëndë dhe kishte vdekur në vitin 1997 si rezultat i një shkëmbimi zjarri me policinë në Rrethin e Beratit gjatë periudhës së trazirave civile që pasuan rënien e skemave piramidale. Procesi penal për vrasjen e vëllait të kërkuesit ishte ndërprerë më 10 maj 2000. Gjykata e Rrethit gjeti që kërkuesi dhe prindërit e tij e mbanin përgjegjësi I. N. si punonjës i forcave policore që kishte qenë i përfshirë në ngjarjet e vitit 1997. Gjykata e Rrethit e konsideroi vrasjen e I. N. nga kërkuesi si një akt hakmarrjeje për vdekjen e vëllait të kërkuesit. Në mbështetje të këtij përfundimi, ajo iu referua edhe dëshmisë së dhënë nga nëna e kërkuesit gjatë procesit gjyqësor (shihni paragrafin 32 më sipër).

Gjykata e Rrethit konstatoi që kërkuesi kishte ideuar një plan për të vrarë I. N.

Gjykata e Rrethit Vlorë u mbështet në prova rrethimore në trajtimin e veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J., të cilat përfshinin dyshime që kërkuesi e konsideronte I. N. përgjegjës për vdekjen e vëllait të tij, I. J. Gjykata e Rrethit Vlorë konfirmoi që më 7 shtator 2000 në Qafën e Koshovicës në Fier, kërkuesi dhe persona të tjerë të paidentifikuar i kishin zënë pritë I. N. dhe A. J. kur kishin kaluar me makinë. I. N. u plagos nga një predhë, por mbijetoi. Gjykata e Rrethit iu referua deklaratimit të B. H. të dhënë në polici ku thoshte se e kishte takuar kërkuesin në Athinë dhe se i kishte thënë se kishte qëlluar ndaj I. N.

Lidhur me vrasjen e I. N. më 30 dhjetor 2000, Gjykata e Rrethit gjeti që kërkuesi dhe shoku i tij D. Zh. kishin udhëtuar së bashku me autobus nga Fieri në Vlorë atë mëngjes. Kur mbërritën në terminalin e autobusëve në Vlorë, ata takuan R. B. dhe kërkuesi i kishte kërkuar që t'i jepte makinën për të shkuar në qendër të Vlorës për të “mbaruar ca punë”. R. B. kishte pranuar. Kur kërkuesi dhe D. Zh. ishin duke udhëtuar me makinë përgjatë rrugës Vlorë-Skelë, ata kishin parë I. N. të ulur në një lokal me B. T. pranë shtëpisë së I. N. Pasi parkuan makinën, ata iu afruan I. N. nga pas. Kërkuesi qëndroi pas një qosheje të lokalit, ndërsa D. Zh. iu afrua I. N. nga mbrapa në një distancë prej rreth dy metrash, nxori armën e tij dhe qëlloi disa herë ndaj I. N. I. N. tentoi të nxjerrë pistoletën që mbante me vete, por nuk ia doli. Ai ra përtokë dhe vdiq pothuajse në vend. Kërkuesi rrëmbeu D. Zh. dhe ata u larguan me nxitim nga vendi i ngjarjes dhe u drejtuan për në shtëpinë e B. M. në fshatin Levan në rrethin e Fierit, ku u fshehën, për të shmangur ndjekjen nga policia.

Gjykata e Rrethit Vlorë arriti në përfundimin se rrjedha e ngjarjeve të mësipërme ishte provuar plotësisht nga të gjitha provat. Ajo gjeti që kërkuesi dhe D. Zh. kishin bërë një marrëveshje. Kërkuesi kishte organizuar vrasjen e I. N. dhe kishte siguruar bashkëpunimin e shokut të tij të ngushtë D. Zh. Gjykata e Rrethit Vlorë u mbështet në një sërë provash të drejtpërdrejta, rrethimore dhe shkencore, përkatesisht raporte nga vendngjarja, raporti i autopsisë, ekspertiza balistike, rezultatet e paraqitjes për njohje, fotografi dhe deklarime të dëshmitarëve A. J., R. B., E. Ll., B. H., B. T., A. L., E. B., A. Ç., B. M., Sh. O., S. M., Th. N. dhe L. J. Në veçanti, ajo theksoi se mamaja e kërkuesit, L. J., kishte deklaruar para gjykatës se vrasja e djalit të saj I. J. ishte kryer nga policia dhe se viktimë, I. N., jo vetëm që e kishte vrarë djalin e saj, por kishte ngacmuar edhe familjen e saj dhe duhej të vdiste, dhe se për këtë arsye kërkuesi kishte filluar të “ngatërrohej” me të.

42. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit nuk u paraqit ankim brenda afatit të caktuar dhe vendimi mori formë të prerë.

IV. PROCESI NË APEL

43. Kërkuesi u lirua nga paraburgimi në Spanjë më 24 maj 2004.

Pasi ekstradimi i kërkuesit në Shqipëri u urdhërua nga dy shkallë gjykatash në Spanjë, më 13 shkurt 2006, Gjykata Kushtetuese refuzoi kërkesën për ekstradim.

44. Më 20 tetor 2008, kërkuesi u arrestua në Itali dhe u ekstradua në Shqipëri. Kërkuesi pretendoi se vetëm atëherë kishte mësuar për dënimin e tij. Rrjedhimisht, më 24 tetor 2008, ai kërkoi rivendosje në afat sipas nenit 147 paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

45. Më 20 nëntor 2008 dhe 16 shkurt 2009, Gjykata e Rrethit Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë përkatësisht rrëzuan kërkesën e kërkuesit me arsyetimin se kërkuesi ishte përfaqësuar në gjykim nga një avokat i caktuar nga familja e tij, i cili mund të kishte paraqitur ankimin në emër të tij. Përveç kësaj, të dyja gjykatat gjetën që kërkuesi duhej të supozohej se kishte qenë në dijeni të proceseve penale kundër tij dhe se ai nuk kishte paraqitur asnjë provë për të kundërshtuar këtë supozim. Sipas nenit 147 paragrafi 2 të KPP-së, kërkuesi ka barrën e provës që ai nuk ka qenë në dijeni të proceseve kundër tij.

46. Më 2 korrik 2009, Gjykata e Lartë miratoi kërkesën e kërkuesit për rivendosje në afat, duke prishur vendimet e mëparshme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjykata e Lartë nuk gjeti prova bindëse që kërkuesi kishte qenë në dijeni të proceseve gjyqësore dhe dënimit të tij, dhe që barra e provës për dijeninë e kërkuesit në lidhje me proceset dhe dënimin e tij ishte mbi Shtetin.

47. Më 8 korrik 2009, kërkuesi paraqiti ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë ku kërkoi ("*përsëritjen pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor*") sipas nenit 427 të KPP-së për shkak të mungesës së tij në procesin gjyqësor. Lidhur me dënimin e tij për vrasjen e mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J. më 7 shtator 2000, kërkuesi pretendoi se deklaratimet e dëshmitarëve R. B. dhe B. H. ishin sajuar. Sipas këtyre deklaratimeve, kërkuesi i kishte rrëfyer dëshmitarët B. H. në një stacion autobusi në Athinë se ai kishte organizuar dhe kryer zënien në pritë të I. N. dhe A. J. në Qafën e Koshovicës. Gjithashtu, ai kundërshtoi deklaratimin e dëshmitarit R. B. sipas të cilit kërkuesi kishte pranuar se kishte kryer veprën penale në fjalë. Në fund, kërkuesi deklaroi se as B. H. dhe as R. B. nuk ishin dëshmitarë okularë dhe meqenëse ata kishin munguar në procesin gjyqësor, deklaratimet e tyre duhej të rrëzoheshin.

Lidhur me dënimin e tij për vrasjen e I. N., kërkuesi deklaroi se sipas dëshmive të tyre, dëshmitarët B. T., E. B. dhe A. B. (të gjithë kishin qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes) kishin parë vetëm një person të qëllonte viktimën, I. N., në kundërshtim me përfundimet e Gjykatës së Rrethit Vlorë. Ai person, pretendoi kërkuesi, ishte D. Zh., dhe nuk kishte prova që vrasja ishte urdhëruar ose organizuar nga kërkuesi.

Gjithashtu kërkuesi kundërshtoi gjetjen e gjykatës së shkallës së parë se ai e kishte kërcënuar I. N. dhe u shpreh që nuk kishte prova për këtë gjetje. Ai deklaroi se kishte pasur parregullsi procedurale në lidhje me disa nga provat e paraqitura.

48. Gjykata e Apelit Vlorë caktoi një seancë dëgjimore më 12 shkurt 2010 dhe thirri kërkuesin dhe avokatin e tij. Ajo rrëzoi kërkesën që të dëgjoheshin përsëri dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve, duke vendosur se mjaftonte që provat ishin paraqitur para gjykatës së shkallës së parë.

49. Një seancë dëgjimore u mbajt në Gjykatën e Apelit Vlorë më 12 shkurt 2010. Kërkuesi, i cili ishte në paraburgim në atë kohë, u njoftua për seancën dëgjimore dhe iu dha mundësia që të ishte në seancë. Megjithatë, ai vendosi të mos merrte pjesë dhe të përfaqësohej nga avokati i tij, i njëjti i zgjedhur nga familja e tij për ta përfaqësuar atë në procesin gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Vlorë.

Avokati i kërkuesit lexoi ankimin. Ai u shpreh që kërkuesi ishte ndaluar në Spanjë dhe për këtë arsye nuk mund të merrte pjesë në gjyqin e tij. Ai kërkoi që të gjithë dëshmitarët të thirreshin përsëri,

por kjo kërkesë u refuzua me arsyetimin se gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë nuk ishin shkelur rregulla procedurale që do ta kishin bërë të pavlefshme paraqitjen e provave të prokurorisë.

50. Më 12 prill 2010, Gjykata e Apelit Vlorë e rrëzoi ankimin dhe la në fuqi dënimin e kërkuarit. Ajo konstatoi se dënimi i kërkuarit në shkallën e parë kishte qenë rezultat i një gjykimi të drejtë pa asnjë parregullsi procedurale, ku prokuroria kishte paraqitur një sasi të konsiderueshme provash që kishin qenë vendimtare në lidhje me fajësinë e kërkuarit për organizimin e vrasjes dhe fajësinë e D. Zh. për kryerjen e saj. Në veçanti, ajo refuzoi kërkesën e kërkuarit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 427 të KPP-së, duke konstatuar se të gjitha provat ishin vlerësuar tashmë në shkallën e parë në prani të avokatit të kërkuarit, i cili ishte caktuar nga familja e tij, megjithëse jo në prani të kërkuarit. Gjykata e Apelit Vlorë theksoi se kërkuari ishte në paraburgim, por kishte zgjedhur të mos merrte pjesë në proceset gjyqësore, dhe se interesat e tij ishin mbrojtur mjaftueshëm nga avokati i tij i caktuar.

51. Më 4 maj 2010, kërkuari paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë dhe paraqiti të njëjtat argumente si në ankimin e tij në Gjykatën e Apelit Vlorë (shihni paragrafin 47 më sipër). Më 4 korrik 2013, Gjykata e Lartë e rrëzoi përfundimisht rekursin pasi nuk paraqiste asnjë nga shkaqet e rekursit të përmendura në nenin 432 të KPP-së.

52. Më 25 shkurt 2014, kërkuari depozitoi një ankim kushtetues. Ai kundërshtoi mënyrën se si ishin mbledhur provat dhe pretendoi, *inter alia*, se nuk ishte njoftuar siç duhej për akuzat kundër tij dhe se gjykatat e shkallës së parë nuk kishin dhënë arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre.

53. Më 29 shtator 2014, Gjykata Kushtetuese e pranoi pjesërisht ankimin kushtetues të kërkuarit dhe e ktheu çështjen në Gjykatën e Lartë. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin e kërkuarit në lidhje me mënyrën se si ishin marrë deklaratimet e dëshmitarëve dhe arsyet e dhëna nga gjykatat e shkallëve më të ulëta. Ajo pranoi se kishte pasur disa parregullsi në mënyrën se si ishin mbledhur disa nga provat nga prokuroria, por gjeti që ato ishin të pamjaftueshme për ta bërë procesin të padrejtë, duke pasur parasysh provat mbështetëse kundër kërkuarit. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin e kërkuarit në lidhje me pretendimin për mosnjoftimin e kërkuarit nga gjykata e shkallës së parë për proceset gjyqësore, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë më përpara kishte konstatuar që kërkuari ishte i arratisur. Ajo rrëzoi ankimin në lidhje me të drejtën e tij për t'u dëgjuar, duke u shprehur që Gjykata e Lartë e kishte miratuar kërkesën e tij për rivendosje në afat dhe që, edhe pse ai ishte gjykuar *in absentia*, ai kishte pasur mundësinë të ankimonte dënimin e tij.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese pranoi ankimin kushtetues të kërkuarit në lidhje me drejtësinë e procesit në Gjykatën e Lartë. Ajo u shpreh që Gjykata e Lartë duhej të kishte dhënë arsye për vendimin e saj nëse kërkesa e kërkuarit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor ishte e bazuar apo jo. Në këto rrethana, ajo prishi vendimin e Gjykatës së Lartë dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim.

54. Më 5 nëntor 2015, Gjykata e Lartë e rrëzoi përsëri rekursin e kërkuarit, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë të 12 prillit 2010. Ajo vërejti se thelbi i ankimeve të kërkuarit kishte të bënte me marrjen dhe interpretimin e provave nga gjykatat më të ulëta, gjë që ishte jashtë juridiksionit të saj. Lidhur me shkeljen e pretenduar procedurale të së drejtës për një gjykim të drejtë, Gjykata e Lartë vlerësoi që asgjë në dosje nuk e mbështeste këtë përfundim. Ajo konstatoi se gjykatat kishin ndjekur të gjitha hapat e duhura procedurale për njoftimin e kërkuarit për proceset penale kundër tij dhe se interesat e tij ishin përfaqësuar nga një avokat, i cili fillimisht ishte caktuar nga familja e tij dhe më pas ishte zgjedhur edhe nga vetë kërkuari. Për më tepër, Gjykata e Lartë vërejti se kërkuari kishte hequr dorë nga të drejtat e tij të mbrojtjes përmes mungesës së tij, gjë që ajo gjeti se e kishte bërë vullnetarisht, si në gjykimin e shkallës së parë ashtu edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë gjatë vendimmarrjes për kërkesën e tij për përsëritje të pjesshme të shqyrtimit gjyqësor (shihni paragrafët 49 më sipër). Gjykata e Lartë gjeti se kërkuari kishte zgjedhur vullnetarisht të mos përfitonte nga garancitë e parashikuara nga neni 427 paragrafi 4 i KPP-së.

55. Më 27 shkurt 2017, kërkuesi paraqiti një ankim të ri kushtetues. Ai pretendoi, *inter alia*, se ishte gjykuar në mungesë dhe se në proceset e përsëritura ishte shkelur parimi i kundërshtimit sepse kërkesa e tij që të thirreshin përsëri të gjithë dëshmitarët ishte refuzuar, dhe për këtë arsye ai nuk kishte pasur mundësi praktike që të kundërshtonte dëshmitë kundër tij.

56. Më 22 maj 2017, Gjykata Kushtetuese i rrëzoi të gjitha ankimet e përsëritura kushtetuese, duke vënë në dukje se ajo tashmë i kishte gjykuar ato dhe se në lidhje me vendimin e kontestuar, Gjykata e Lartë kishte respektuar udhëzimet e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj të 29 shtatorit 2014.

LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

I. KODI PENAL

57. Neni 79-c parashikon që vrasja e një punonjësi policie *inter alia*, dënohet me jo më pak se njëzet e pesë vite burg ose me burgim të përjetshëm.

II. KODI I PROCEDURËS PENALE

58. Dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (në fuqi në kohën e ngjarjes), lexojnë si më poshtë:

Neni 147 - Rivendosja në afat

“1. Prokurori, i pandehuri, palët private dhe avokati mbrojtës mund të kërkojnë shtyrje të afatit nëse provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të ngjarjeve të paparashikuara ose të forcës madhore.

2. Në rastin e dënimit *në mungesë*, i akuzuari mund të kërkojë shtyrjen e afatit të ankimit kundër vendimit nëse mund të provojë se nuk ka pasur dijeni për procesin.

3. Kërkesa për rivendosje në afat për ankim mund të depozitohet brenda dhjetë ditëve nga data e mbarimit të ngjarjeve të paparashikuara ose forcës madhore [të përmendur në paragrafin 1], dhe në lidhje me një kërkesë sipas paragrafit 2 [brenda dhjetë ditëve] nga data e marrjes dijeni nga i pandehuri për vendimin për herë të parë. (...)

...
5. Vendimi për shtyrjen e afatit të ankimit [kundër një vendimi] duhet të ankimohet në lidhje me një ankim kundër vendimit për themelin e çështjes.

6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit”.

Neni 427

Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor

“1. Kur ankimi i palës përfshin një kërkesë për rimarrjen e provave të paraqitura në gjykim në shkallë të parë ose për marrjen e provave të reja, gjykata [e apelit] kur e gjykon të nevojshme vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor tërësisht ose pjesërisht.

2. Nëse gjatë gjykimit në shkallë të parë zbulohen prova të reja, ose këto prova dalin gjatë apelit, gjykata vendos nëse do të pranojë ose jo këto prova.

3. [Gjykata e apelit] mund të urdhërojë përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor nëse e vlerëson të nevojshme në interes të drejtësisë.

4. Gjykata e [apelit] urdhëron përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor nëse është provuar se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykimin në shkallë të parë për shkak të mosnjohimit [për gjykimin] ose pamundësisë për t’u paraqitur për shkaqe të ligjshme.

5. Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor sipas paragrafëve të mëparshëm të kësaj dispozite duhet të fillojë menjëherë dhe, kur kjo nuk është e mundur, gjykimin mund të shtyhet pas jo më shumë se dhjetë ditëve”.

59. Dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 të 30 marsit 2017), lexojnë si më poshtë:

Neni 450 – Rastet e rishikimit

“Rishikimi [i një vendimi përfundimtar] mund të kërkohet:

(...)

c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të

cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;

(...)

(e) kur shkaku për rishikimin e vendimit të formës së prerë rezulton nga një vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që e bën të domosdoshëm rigjykimin e çështjes....

(...)
(g) kur personi është gjykuar *in absentia* dhe kërkon rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes dijeni [për gjykimin *in absentia*] ...”

Neni 455- Gjykimi i rishikimit

(...)
“(2) Respektohen dispozitat e gjykimit të shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të parashtruara në kërkesën e rishikimit.”

LEGJISLACIONI

I. OBJEKTI I ÇËSHTJES

60. Në kërkesën e tij fillestare, si dhe në përgjigjen e tij ndaj parashtrimeve të Qeverisë, kërkuesi paraqiti, ndër të tjera, ankimin sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me vdekjen e vëllait të tij, dhe sipas nenit 6 §§ 1 dhe 2 të Konventës, që gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë nuk ishin të paanshëm dhe se ishte shkelur e drejta e tij për prezumimin e pafajësisë. Në fazën e komunikimit, këto ankime u shpallën të papranueshme nga Kryetari i Seksionit, i cili gjykoi si gjyqtar i vetëm (sipas Rregullave 27A § 2 (a) dhe 54 § 3 të Rregullores së Gjykatës të lexuara së bashku me Rregullin 12) dhe për pasojë Qeveria nuk u njoftua për këto ankime. Një vendim i tillë është përfundimtar (neni 27 § 2 i Konventës dhe Rregulli 54 § 3) dhe për këtë arsye Gjykata nuk do t'i rishqyrtojë ato ankime (shihni *Mazepa dhe të tjerë kundër Rusisë*, nr. 15086/07, §§ 61-62, 17 korrik 2018, dhe *Korporativna Targovska Banka AD kundër Bullgarisë*, nr. 46564/15 dhe 68140/16, § 115, 30 gusht 2022).

II. PRETENDIMI PËR SHKELJEN E NENIT 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d) TË KONVENTËS

61. Kërkuesi u ankua që nuk i ishte lejuar përsëritja e shqyrtimit gjyqësor pas gjykimit të tij në mungesë dhe që ai nuk kishte pasur mundësi të pyeste dëshmitarët e akuzës R. B. dhe B. H. Ai gjithashtu u ankua që Gjykata e Lartë nuk kishte dhënë arsye të mjaftueshme në vendimin e saj dhe u ankua për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore. Ai u mbështet në nenin 6 § 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës, pjesa përkatëse e së cilës lexon si më poshtë:

“Në përcaktimin eçdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë.....”.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

(...)

(c) të mbrohet vetë...;

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
...”

A. Pranueshmëria

1. E drejta e kërkuetit për të marrë pjesë në proceset kundër tij dhe për të pyetur dëshmitarët e akuzës

62. Qeveria pretendoi se kërkuesi nuk i kishte shteruar siç duhej mjetet juridike të brendshme në dispozicion, sepse nuk kishte bërë një ankim të ri kushtetues në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të 5 nëntorit 2015 (shihni paragrafin 54 më sipër). Qeveria gjithashtu pretendoi se vendimi përfundimtar i brendshëm ishte marrë nga Gjykata e Lartë më 5 nëntor 2015, ndërsa kjo kërkesë ishte bërë në Gjykatë më 22 prill 2016, jashtë afatit gjashtëmuor sipas nenit 35 § 1 të Konventës, siç ishte në fuqi në kohën përkatëse.

63. Kërkuesi pretendoi se kishte bërë ankim kushtetues dhe se vendimi përfundimtar ishte marrë nga Gjykata Kushtetuese më 22 maj 2017, kështu që ai kishte respektuar afatin gjashtëmuor.

64. Gjykata vëren se, ndryshe nga pretendimi i Qeverisë, kërkuesi paraqiti një ankim të ri kushtetues kundër vendimit të Gjykatës së Lartë të 5 nëntorit 2015, dhe Gjykata Kushtetuese e rrëzoi më 22 maj 2017 (shihni paragrafin 56 më sipër), i cili ishte gjithashtu vendimi përfundimtar në çështjen e kërkuetit.

65. Rrjedhimisht, kundërshtimet e Qeverisë në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme juridike dhe respektimin e afatit gjashtëmuor duhet të rrëzohen.

66. Gjykata vëren se këto ankime nuk janë as haptazi të pabazuara dhe as të papranueshme për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës.. Prandaj, ato duhet të shpallen të pranueshme.

2. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë

67. Kërkuesi u ankua se Gjykata e Lartë nuk kishte dhënë arsye të mjaftueshme për vendimin e saj të 5 nëntorit 2015, duke rrëzuar ankimin e tij për çështje të ligjit (shihni paragrafin 54 më sipër).

68. Qeveria pretendoi se arsyet e dhëna nga Gjykata e Lartë ishin adekuate dhe të mjaftueshme.

69. Parimet e përgjithshme përkatëse në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore në proceset penale janë përmbledhur në *Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr. 2) ([DHM], nr. 19867/12, §§ 83-84, 11 korrik 2017), dhe *Lobzhanidze dhe Peradze kundër Gjeorgjisë* (nr. 21447/11 dhe 35839/11, §§ 65 66, 27 shkurt 2020).

70. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur që nuk mund t'i shqyrtonte ankimet e kërkuesit në lidhje me vlerësimin e provave nga gjykatat më të ulëta, sepse ato kishin të bënin me çështje jashtë juridiksionit të saj. Lidhur me të metat e pretenduara procedurale, ajo u shpreh që këto pretendime ishin të pabazuara dhe që gjykatat e shkallëve më të ulëta kishin ndjekur procedurën e përcaktuar në të gjitha drejtimit. Gjithashtu, ajo arriti në përfundimin se kërkuesi kishte hequr dorë nga të drejtat e tij të mbrojtjes nëpërmjet mungesës së tij në seancën dëgjimore në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata do të theksonte në këtë pikë se nuk ishte e interesuar nëse vendimet e marra nga gjykatat e brendshme në çështjen konkrete ishin të sakta dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm (krahasoni *Deryan kundër Turqisë*, nr. 41721/04, § 34, 21 korrik 2015, dhe *Ruminski kundër Suedisë*, nr. 17906/15, § 31, 2 maj 2017).

71. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka dhënë mendimin e saj mbi secilin prej ankimeve të kërkuesit dhe kështu ka trajtuar çështjet thelbësore që i janë kërkuar të trajtojë. Ajo ka dhënë arsye adekuate, megjithëse shkurt (krahasoni *Ruminski*, cituar më sipër, § 33), dhe këto arsye nuk mund të shihen si automatike ose stereotipe (shihni *Moreira Ferreira*, cituar më sipër, § 84; *Malo kundër Shqipërisë*, nr. 72359/11, § 32, 22 maj 2018; dhe *Aykhan Akhundov kundër Azerbajxhanit*, nr. 43467/06, § 87, 1 qershor 2023). Në këtë drejtim, Gjykata përsërit se, megjithëse neni 6 § 1 i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, ai nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të detajuar për çdo pretendim (shihni *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 26, GJEDNJ 1999-I). Në këtë çështje, Gjykata e Lartë nuk mënjanoi një çështje specifike, përkatëse dhe të rëndësishme të ngritur nga kërkuesi (shihni *Nechiporuk dhe Yonkalo kundër Ukrainës*, nr. 42310/04, § 280, 21 prill 2011; *Rostomashvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 13185/07, § 59, 8 nëntor 2018; dhe *Zhang kundër Ukrainës*, nr. 6970/15, § 73, 13 nëntor 2018).

72. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit Vlorë ka dhënë arsye të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse për vendimin e saj (krahasoni me *Deryan*, të cituar më sipër, § 37).

73. Rrjedhimisht, duke vlerësuar procesin në tërësi, Gjykata konstaton se ishte përmbushur e drejta e kërkuesit që çështja e tij të shqyrtohej siç duhej nga gjykatat e brendshme dhe detyrimi i tyre për të dhënë arsye adekuate për vendimet e tyre.

74. Nga kjo vijon që kjo kërkesë duhet të shpallet e papranueshme si haptazi e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) dhe duhet të refuzohet sipas nenit 35 § 4 të Konventës.

3. Kohëzgjatja e procesit gjyqësor

75. Kërkuesi pretendoi se kohëzgjatja e përgjithshme e procesit gjyqësor kishte qenë e tepruar.

76. Qeveria pretendoi se proceset kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm.

77. Parimet e përgjithshme në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përmbledhen në çështjen *Frydlander kundër Francës* ([DHM], nr. 30979/96, § 43, GJEDNJ 2000-VII).

78. Proceset për të cilat është bërë ankimi kanë filluar më 24 tetor 2008 kur kërkuesi kërkoi rivendosje në afat (shihni paragrafin 31 më sipër) dhe përfunduan me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 22 majit 2017. Kështu ato zgjatën tetë vjet, gjashtë muaj dhe njëzet e tetë ditë në gjykatat e të katër shkallëve të juridiksionit. Për shkak se disa vendime u kthyen për rigjykim, gjithsej u dhanë tetë vendime (krahasoni *Šeliga kundër Sllovenisë* (vendim), nr. 33578/02, 30 nëntor 2006, dhe *Zela kundër Shqipërisë* nr. 33164/11, § 45, 11 qershor 2024).

79. Gjykata vlerëson se kjo çështje ishte mjaft e ndërlikuar sepse kishte të bënte me çështje sensitive të lidhura me vepra të rënda penale.

80. Gjykata konstaton se kërkuesi ka kontribuar në kohëzgjatjen e proceseve duke paraqitur ankimin e parë kushtetues rreth shtatë muaj pas dhënies së vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë (shihni paragrafët 51 dhe 52 më sipër). Ai gjithashtu depozitoi ankimin e dytë kushtetues më shumë se pesëmbëdhjetë muaj pas vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë (shihni paragrafët 54 dhe 55 më sipër dhe krahasoni me *Zela*, cituar më sipër, § 47). Prandaj ai kontribuoi në vonesën e përgjithshme të proceseve me njëzet e dy muaj.

81. Gjykata vëren se asnjë prej gjykatave të brendshme që trajtoi çështjen nuk mori më shumë se tre vjet kohë për të dhënë vendimin e saj. Duke pasur parasysh këtë vëzhgim dhe praktikën gjyqësore të saj (shihni, për shembull, *L.Z. kundër Sllovakisë* (vendim), nr. 27753/06, 27 shtator 2011, dhe *Lyszczyńska kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 34863/04, 4 janar 2008), Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e përgjithshme prej tetë vjetësh në katër shkallë juridiksioni, me vendime të dhëna në tetë çështje të veçanta, nuk e ka kaluar atë që mund të konsiderohej kohë e arsyeshme në këto rrethana (krahasoni *Ekholm kundër Finlandës* (vendim), nr. 5952/03, 10 korrik 2007, dhe *Steiner kundër Austrisë* (vendim), nr. 32637/96, 22 nëntor 2001; dhe *Zela*, cituar më sipër, §§ 45-49).

82. Për rrjedhojë, Gjykata gjen që kjo pjesë e kërkesës është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

83. Kërkuesi pretendoi se nuk kishte pasur dijeni për proceset penale kundër tij. Ai ishte ndaluar në Spanjë dhe ishte në pritje të ekstradimit në Shqipëri kur ndaj tij u zhvillua procesi gjyqësor. Atij nuk i ishte dorëzuar asnjë dokument në lidhje me çështjen kundër tij në Shqipëri. Avokati i tij kishte kërkuar që gjyqi të shtyhej deri në ekstradimin e tij, por Gjykata e Rrethit Vlorë vazhdoi procesin gjyqësor, kështu e pengoi pjesëmarrjen e tij.

84. Kërkuesi parashtroi se vetëm pasi u arrestua më 20 tetor 2008 u vu në dijeni për akuzat kundër tij.

85. Edhe pse u lejua rivendosja në afat, kërkesa e tij që dëshmitarët të dëgjoheshin përsëri në praninë e tij u rrëzua. Në veçanti, gjykatat u mbështetën në deklaratimet e dhëna me shkrim më parë nga dëshmitarët në mungesë B. H. dhe R. B.

86. Të dy kishin deklaruar se një javë pas vrasjes së I. N., kërkuesi iu kishte thënë se ai e kishte vrarë I. N. Dëshmitari B. H. deklaroi se kërkuesi ia kishte thënë këtë në Athinë, Greqi, dhe dëshmitari R. B. deklaroi se ia kishte thënë në Fier, Shqipëri, në të njëjtën kohë. Megjithatë, kjo nuk ishte e mundur, sepse kërkuesi nuk mund të kishte qenë në dy vende të ndryshme në të njëjtën kohë. Gjykatat e brendshme nuk kishin dhënë asnjë shpjegim për këtë. Kërkuesi gjithashtu pretendoi se, përveç deklaratimeve të pabesueshme të këtyre dy dëshmitarëve, nuk kishte prova të tjera bindëse kundër tij. Deklarimet e këtyre dy dëshmitarëve ishin baza e vetme për dënimin e tij.

87. Kërkuesi gjithashtu pretendoi se kur këta dy dëshmitarë kishin dhënë deklaratimet e tyre në polici, nuk ishin identifikuar siç duhej sepse nuk kishin paraqitur asnjë dokument identifikimi.

88. Kërkuesi pretendoi më tej se dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët B. T. dhe A. L. në Gjykatën e Rrethit Vlorë nuk ishin dhënë në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Këta dy dëshmitarë nuk

mund t'i mbanin mend ngjarjet në fjalë. Gjykata e shkallës së parë më pas u dha atyre kopje të deklaramëve që kishin dhënë në polici, të cilat oficeri i policisë i kishte shkruar. Megjithatë, sipas legjislacionit të brendshëm, një dëshmitar që jepte dëshmi në gjyq lejohej vetëm të konsultohet shënimet e veta, dhe jo ato të shkruara nga një oficer policie.

89. Kërkuesi gjithashtu pretendoi se gjykatat e brendshme kishin keqinterpretuar disa prova të tjera, dhe, në veçanti, dëshminë e dhënë nga mamaja e tij, duke nxjerrë gabimisht përfundimin se ajo kishte thënë që kërkuesi kishte planifikuar të vriste I. N.

90. Qeveria pretendoi se kërkuesi kishte qenë në dijeni të proceseve kundër tij dhe se në gjyqin e zhvilluar në mungesë të tij ishin respektuar të gjitha rregullat procedurale. Sidoqoftë, atij i ishte pranuar kërkesa për rivendosje në afat dhe i ishte dhënë mundësia të merrte pjesë në seancën dëgjimore para Gjykatës së Apelit Vlorë për të paraqitur mbrojtjen e tij.

91. Lidhur me dëshminë e dëshmitarëve në mungesë R. B. dhe B. H. të marra si deklaramë me shkrim në mungesë të tyre, Qeveria pretendoi se autoritetet kishin bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të thirrur R. B. dhe B. H. Megjithatë, të dy kishin qenë jashtë shtetit dhe të padisponueshëm.

92. Sipas Qeverisë, dëshmitë e dhëna nga këta dëshmitarë kishin qenë vetëm prova mbështetëse dhe nuk kishin qenë vendimtare në përcaktimin e fajësisë së kërkuesit, dhe prova të tjera bindëse kishin luajtur rol vendimtar në këtë drejtim. Qeveria u mbështet në kallëzimin e I. N. për vrasjen e mbetur në tentativë ndaj tij (shihni paragrafin 9 më sipër), raportin e autopsisë, ekspertizën kriminalistike dhe dëshmitë e dhëna nga dëshmitarë të tjerë, përfshirë A. J., E. L., A. L., E. B., A. C., B. M., S. O., S. M. dhe Th. N., dhe mamën e kërkuesit, L. J.

93. Qeveria pretendoi më tej se avokati i kërkuesit kishte pasur mundësinë të kundërshtonte të gjitha provat. Gjykatat e brendshme gjithashtu u kishin dhënë më pak peshë dëshmimeve të dëshmitarëve R. B. dhe B. H. dhe i kishin peshuar deklaramet e tyre kundrejt provave të tjera.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme në lidhje me drejtësinë e përgjithshme të procesit

94. Gjykata thekson se, ndërsa kërkesat e paragrafit 3 të nenit 6 duhet të shihen si aspekte të veçanta të së drejtës për seancë dëgjimore të drejtë të garantuar nga paragrafi 1, ajo shpesh shqyrton ankimet sipas të dyjave dispozitave të marra së bashku (shihni, mes vendimeve të tjera, *Al-Khawaja and Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 26766/05 dhe 22228/06, § 118, GJEDNJ 2011, dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 9154/10, § 100, GJEDNJ 2015). Gjithashtu, kur kërkuesi ankohet për disa të meta procedurale, Gjykata mund të shqyrtojë shkaqet e ndryshme që kanë çuar në paraqitjen e ankimit me qëllim për të përcaktuar nëse proceset, të vlerësuara në tërësi, kanë qenë të drejta (shihni *Insanov kundër Azerbajxhanit*, nr. 16133/08, §§ 159 et seq. 14 mars 2013; *Mirilashvili kundër Rusisë*, nr. 6293/04, §§ 164 et seq., 11 dhjetor 2008; dhe *Tuskia dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë*, nr. 14237/07, § 98, 11 tetor 2018).

95. Shqetësimi kryesor i Gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës është të vlerësojë drejtësinë e përgjithshme të procesit penal (shihni, mes shumë vendimeve të tjera, *Taxquet kundër Belgjikës* [DHM], nr. 926/05, § 84, GJEDNJ 2010, dhe *Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 101). Pajtueshmëria me kërkesat e një gjykimi të drejtë duhet të shqyrtohet në çdo rast duke pasur parasysh zhvillimin e proceseve në tërësi dhe jo në bazë të një vlerësimi të izoluar të një aspekti të veçantë ose të një incidenti të veçantë. Në kryerjen e këtij vlerësimi, Gjykata do të shqyrtojë proceset në tërësi, duke pasur parasysh të drejtat e mbrojtjes, por edhe interesat e publikut dhe të viktimës/viktimave për ndjekjen e duhur penale të krimit (shihni *Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 101; *Gäffen kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 22978/05, § 175, GJEDNJ 2010; dhe *Okropiridze kundër Gjeorgjisë*, nr. 43627/16 dhe 71667/16, § 80, 7 shtator 2023).

a) Parime të përgjithshme në lidhje me gjykimin në mungesë

96. Gjykata përsërit parimet e përgjithshme në lidhje me proceset *in absentia* siç përshkruhen në *Sejdonic kundër Italisë* ([DHM], nr. 56581/00, GJEDNJ 2006-II (fshirë referencat)).

“81. Edhe pse kjo nuk përmendet shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 6, objekti dhe qëllimi i nenit të marra në tërësi tregojnë se një person “i akuzuar për një vepër penale” ka të drejtë të marrë pjesë në seancën dëgjimore. Për më tepër, nënparagrafët (c), (d) dhe (e) të paragrafit 3 i garantojnë “çdo personi të akuzuar për një vepër penale” të drejtën “për t’u mbrojtur personalisht”, “për të marrë në pyetje ose për të kërkuar që të merren në pyetje dëshmitarët” dhe “për të marrë ndihmën falas të një përkthyesi nëse nuk mund ta kuptojë ose të flasë gjuhën e përdorur në gjykatë”, dhe është e vështirë të kuptohet se si ai mund t’i ushtrojë këto të drejta pa qenë i pranishëm (...).

82. Edhe pse proceset që zhvillohen në mungesë të të akuzuarit nuk janë në vetvete të papajtueshme me nenin 6 të Konventës, padyshim që drejtësia mohohet kur një person i dënuar *in absentia* nuk është në gjendje të marrë më pas nga një gjykatë që e ka dëgjuar atë një vendim të ri mbi themelin e akuzës, si në lidhje me ligjin ashtu edhe me faktin, kur nuk është vërtetuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur dhe për t’u mbrojtur (...) ose që ka pasur ndërmend t’i shpëtojë gjyqit (...).

83. Konventa u lë Shteteve Kontraktuese diskrecion të gjerë në lidhje me zgjedhjen e mjeteve të llogaritura për të siguruar që sistemet e tyre ligjore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6. Gjykata ka për detyrë të përcaktojë nëse është arritur rezultati i kërkuar nga Konventa. Në veçanti, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni dhe praktika e brendshme duhet të tregohet që janë efektive kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur dhe për t’u mbrojtur, as nuk ka kërkuar t’i shpëtojë gjyqit (...).

84. Gjykata ka vendosur më tej se detyrimi për të garantuar të drejtën e një të pandehuri në proces penal për të qenë i pranishëm në sallën e gjykimit - qoftë gjatë proceseve fillestare ose në një rigjykim - renditet si një nga kërkesat thelbësore të nenit 6 (...). Rrjedhimisht, refuzimi për të rifilluar procesin e zhvilluar në mungesë të të akuzuarit, pa asnjë të dhënë që i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta e tij ose e saj për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit, është gjetur si “mohim flagrant i drejtësisë”, duke i bërë proceset “haptazi në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 ose parimet e mishëruara në të” (...).

85. Gjykata ka vendosur gjithashtu që rivendosja në afat për ankim kundër një dënimi *in absentia*, ku i pandehuri kishte të drejtë të merrte pjesë në seancën dëgjimore në gjykatën e apelit dhe të kërkonte pranimin e provave të reja, nënkuptonte mundësinë e një vendimmarrjeje të re faktike dhe ligjore të akuzës penale, në mënyrë që të mund të thuhet që proceset në tërësi kanë qenë të drejta (...).

86. As shkronja dhe as fryma e nenit 6 të Konventës nuk e pengojnë një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë, qoftë shprehimisht ose në heshtje, nga e drejta për garancitë e një gjykimi të drejtë (...). Megjithatë, nëse do të jetë efektive për qëllimet e Konventës, heqja dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe të shoqërohet nga garanci minimale në përputhje me rëndësinë e saj (...). Për më tepër, ajo nuk duhet të bjerë ndesh me asnjë interes të rëndësishëm publik (...).

(...)

92. Në të njëjtën kohë, është me rëndësi të madhe që një i pandehur të paraqitet, edhe për shkak të së drejtës së tij për një seancë dëgjimore, edhe për shkak të nevojës për të verifikuar saktësinë e deklarimeve të tij dhe për t’i krahasuar me ato të viktimës - interesat e së cilës duhet të mbrohen - dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të dekurajojë mungesat e pajustifikuara, me kusht që çdo sanksion i përdorur të mos jetë joproporcional në rrethanat e çështjes dhe i pandehuri të mos privohet nga e drejta e tij për t’u mbrojtur nga një avokat (...).

93. Gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që një gjykim të jetë i drejtë dhe, në përputhje me rrethanat, që avokatit që merr pjesë në gjykim me qëllimin e dukshëm të mbrojtjes së të akuzuarit në mungesë të tij t’i jepet mundësia ta bëjë këtë (...).

94. Ndërsa i jep kujtdo të akuzuar për një vepër penale të drejtën për të “mbrojtur veten personalisht ose nëpërmjet avokatit ...”, neni 6 § 3 (c) nuk specifikon mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte. Kështu, ua lë Shteteve Kontraktuese zgjedhjen e mjeteve për të siguruar që kjo të sigurohet në sistemet e tyre gjyqësore, ku detyra e Gjykatës është të përcaktojë nëse metoda që kanë zgjedhur është në përputhje me kërkesat e një gjykimi të drejtë (...). Në këtë drejtim, duhet të mbahet mend se Konventa është hartuar për të “garantuar jo të drejta teorike ose imagjinare, por të drejta praktike dhe efektive” dhe se caktimi i një avokati mbrojtës nuk siguron në vetvete efektivitetin e ndihmës që ai mund t’i ofrojë një të pandehuri (...).”.

b) Parime të përgjithshme në lidhje me pranimin e dëshmive të paverifikuara të dëshmitarëve të akuzës që mungojnë në gjyq

97. Në përcaktimin nëse proceset në tërësi kanë qenë të drejta, duhet të merret parasysh edhe nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në veçanti, duhet të përcaktohet nëse të pandehurit i është dhënë mundësia të kundërshtojë vërtetësinë e provave dhe të kundërshtojë pranimin e tyre (shihni *Saakashvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 6232/20 dhe 22394/20, § 124, 23 maj 2024).

98. Parimet e përgjithshme në lidhje me pranimin e dëshmime të paverifikuara fajësuese në procese penale janë përmbledhur në *Al Khawaja dhe Tabery*, cituar më sipër, §§ 118-151, dhe *Schatschaschwili*, cituar më sipër, §§ 100-31). Gjykata përsëriti në ato vendime se neni 6 § 3 (d) sanksiononte parimin që, përpara se një i akuzuar të dënohet, të gjitha provat kundër tij normalisht duhet të paraqiten në praninë e tij në një seancë dëgjimore publike, në mënyrë që ato të mund të kundërshtohen. Përjashtimet nga ky parim janë të mundura, por nuk duhet të kufizojnë të drejtat e mbrojtjes, të cilat, si rregull, kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet një mundësi e mjaftueshme dhe e duhur për të kundërshtuar dhe pyetur një dëshmitar që ka dhënë dëshmi kundër tij - qoftë kur ai dëshmitar bën deklarin e tij ose në një fazë të mëvonshme të procesit (shihni *Al-Khawaja dhe Tabery*, të cituar më sipër, § 118).

99. Në *Al-Khawaja dhe Tabery* (të cituar më sipër, §§ 119-47) Dhoma e Madhe sqaroi parimet që duhen zbatuar kur një dëshmitar nuk ka marrë pjesë në një proces gjyqësor publik. Këto parime mund të përmbledhen si më poshtë (shihni *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 55287/10, § 58, 31 Mars 2016).

i) Së pari, Gjykata duhet të shqyrtojë çështjen paraprake nëse kishte një arsye të mirë për të pranuar dëshminë e një dëshmitari në mungesë, duke pasur parasysh që dëshmitarët, si rregull i përgjithshëm, duhet të japin dëshminë e tyre gjatë procesit gjyqësor dhe që duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar pjesëmarrjen e tyre.

ii) Arsyet tipike për mospjesëmarrje janë, si në çështjen *Al-Khawaja dhe Tabery* (të cituar më sipër), vdekja e dëshmitarit ose frika nga hakmarrja. Megjithatë, ka arsye të tjera legjitime pse një dëshmitar mund të mos marrë pjesë në gjyq.

iii) Kur një dëshmitar nuk është marrë në pyetje në asnjë fazë të mëparshme të procesit, pranimi i deklarin të dëshmitarit në vend të dëshmisë së drejtpërdrejtë në proces gjyqësor duhet të jetë një masë e fundit.

iv) Pranimi si provë i deklarin të dëshmitarëve në mungesë rezulton në një disavantazh të mundshëm për të pandehurin, i cili në një gjykim penal duhet të ketë në parim mundësinë efektive për të kundërshtuar provat kundër tij ose saj. Në veçanti, ai ose ajo duhet të jetë në gjendje të verifikojë vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmime të dhëna nga dëshmitarët duke i marrë ata në pyetje gojarisht në praninë e tij ose të saj, qoftë në kohën kur bëhet deklarimi ose në një fazë të mëvonshme të procesit.

v) Sipas “rregullit e vetme ose vendimtare”, nëse dënimi i një të pandehuri bazohet vetëm ose kryesisht në dëshmitë e ofruara nga dëshmitarët të cilët i pandehuri nuk është në gjendje t'i pyesë në asnjë fazë të procesit, të drejtat e tij ose të saj të mbrojtjes kufizohen padrejtësisht.

vi) Në këtë kontekst, fjala “vendimtar” duhet të kuptohet ngushtë si dëshmi me domethënie ose rëndësi të tillë që ka të ngjarë të jetë përcaktuese për rezultatin e çështjes. Kur dëshmia e paverifikuar e një dëshmitari mbështetet nga prova të tjera konfirmuese, vlerësimi nëse është vendimtar do të varet nga fuqia e provave mbështetëse: sa më të forta të jenë provat e tjera fajësuese, aq më pak ka të ngjarë që dëshmia e dëshmitarit në mungesë të trajtohet si vendimtare.

vii) Megjithatë, meqenëse neni 6 § 3 i Konventës duhet të interpretohet në kontekstin e një shqyrtimi të përgjithshëm të drejtësisë së proceseve, rregulli e vetme ose vendimtare nuk duhet të zbatohet në mënyrë të ngurtë.

viii) Në veçanti, kur një deklarim i bërë jashtë gjykate është dëshmia e vetme ose vendimtare kundër një të pandehuri, pranimi i tij si provë nuk do të rezultojë automatikisht në shkelje të nenit 6 § 1. Në të njëjtën kohë, kur një dënim bazohet vetëm ose në mënyrë vendimtare në deklarin e dëshmitarëve në mungesë, Gjykata duhet t'i shqyrtojë proceset me kujdesin më të madh. Për shkak të rreziqeve të pranimit të këtyre deklarinimeve, ato do të duhej të peshoheshin me shumë kujdes dhe do të kërkonin faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë ekzistencën e garancive të forta procedurale. Pyetja në secilin rast është nëse ekzistojnë faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë

masat që lejojnë një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së atyre dëshmimeve. Kjo do të lejonte që një dënim të bazohej në këto dëshmi vetëm nëse ato janë mjaftueshëm të besueshme duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për çështjen.

100. Këto parime u sqaruan më tej në *Schatschaschwili* (cituar më sipër, § 116), ku Dhoma e Madhe vendosi që Gjykata duhej të vlerësonte ekzistencën e faktorëve të mjaftueshëm kundërbalancues jo vetëm në çështjet ku deklaratimet e dhëna nga një dëshmitar në mungesë janë baza e vetme ose vendimtare për dënimin e kërkuarit, por edhe në ato çështje ku, pas vlerësimit të saj të vlerësimit të gjykatave të brendshme për vlerën e deklaratimeve, ajo nuk e ka të qartë nëse dëshmitë në fjalë ishte baza e vetme ose vendimtare, por megjithatë është e bindur se ato kishin peshë të konsiderueshme dhe se pranimi i tyre mund të ketë penguar mbrojtjen. Gjykata vendosi që shkalla e faktorëve kundërbalancues të nevojshëm që një gjykim të konsiderohet i drejtë do të varej nga pesha e deklaratimeve të dëshmitarit në mungesë. Sa më e rëndësishme të jetë dëshmia, aq më shumë peshë do të duhet të kenë faktorët kundërbalancues në mënyrë që proceset në tërësi të konsiderohen të drejta.

101. Gjykata gjithashtu thekson se cilësia e deklaratimit duhet të merret në konsideratë - duke përfshirë pyetjen nëse rrethanat në të cilat janë marrë krijojnë dyshim mbi besueshmërinë ose saktësinë e tyre. Edhe pse kur dëshmitë e marra nuk mbështeten nga material tjetër nuk krijohet domosdoshmërisht ndonjë problem drejtësie, mund të theksohet se kur provat janë shumë të forta dhe nuk ka rrezik që ato të jenë të pabesueshme, nevoja për prova mbështetëse të jetë përkatësisht më e ulët (shihni *Bykov kundër Rusisë* [DHM], nr. 4378/02, § 90, 10 mars 2009; *Lee Davies kundër Belgjikës*, nr. 18704/05, § 42, 28 korrik 2009; dhe *Saakashvili*, cituar më sipër, § 124, shihni edhe *Lisica kundër Kroacisë*, nr. 20100/06, § 49, 25 shkurt 2010). Megjithatë, pranueshmëria e deklaratimeve është një çështje që duhet rregulluar nga legjislacionit kombëtar dhe gjykatat e brendshme. Shqetësimi i vetëm i Gjykatës është të vlerësojë nëse proceset janë zhvilluar në mënyrë të drejtë (shihni *Gäfgen*, cituar më sipër, § 162, dhe referencat e cituara në të, shihni gjithashtu *Okropiridze*, cituar më sipër, § 80).

c) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

i) E drejta e kërkuarit për të marrë pjesë në proceset kundër tij

102. Gjykata vëren se në kohën e procesit gjyqësor në vitin 2003, kërkuari ishte i ndaluar në Spanjë dhe për këtë arsye nuk mund të ishte i pranishëm në procesin gjyqësor në Shqipëri. Për më tepër, ai ishte shpallur i arratisur nga gjykata e shkallës së parë (shihni paragrafin 53 më sipër). Duhet të supozohet se ai ishte në dijeni të proceseve dhe të akuzave kundër tij, meqenëse atij i ishte dorëzuar urdhri i arrestit dhe dokumente të tjera kur Shqipëria kërkoj ekstradimin e tij. Ai e kishte kundërshtuar këtë kërkesë tek autoritetet spanjolle dhe në këto procese paraqiti si provë një kopje të përkthyer të vendimit të Gjykatës së Rrethit Vlorë, që e dënonte atë *in absentia*. Kjo tregon se ai ishte qartazi në dijeni të proceseve të përfunduara kundër tij në Shqipëri, por zgjodhi të mos kthehej atje. Në vend të kësaj, ai u arrestua në Itali në vitin 2008. Kërkuari nuk ka dhënë asnjë detaj ose sqarim në lidhje me periudhën e ndalimit të tij ose kohën dhe rrethanat e lëvizjes së tij në Itali, ose nëse ai mbajti ndonjë kontakt me familjen e tij ose avokatin e caktuar nga familja gjatë asaj periudhe. Sidoqoftë, duke mos u kthyer në Shqipëri pas lirimit të tij në Spanjë, kërkuari kontribuoi në vonesa në shqyrtimin e çështjes së tij dhe në sigurimin e një rigjykimi.

103. Gjykata vëren se më 2 korrik 2009, Gjykata e Lartë miratoi kërkesën e kërkuarit për rivendosje në afat për ankim sepse ai ishte gjykuar në mungesë (shihni paragrafin 46 më sipër).

104. Pas procesit gjyqësor që u mbajt në mungesë të kërkuarit, avokati që e përfaqësonte atë, i cili ishte caktuar nga familja e tij, nuk paraqiti ankim kundër dënimit të tij në shkallën e parë. Megjithatë, Gjykata vëren se pas arrestimit të tij, kërkuari u lejua të ankimonte dënimin e tij, megjithëse afati kohor për ta bërë këtë kishte mbaruar. Në seancën dëgjimore para Gjykatës së Apelit Vlorë, ai u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur prej tij, i njëjti që ishte caktuar nga familja e tij gjatë procesit në shkallë të parë.

105. Kur iu miratua kërkesa për rivendosje në afat, kërkuesi ishte në paraburgim. Ai nuk ishte i pranishëm personalisht në seancën dëgjimore në Gjykatën e Apelit Vlorë, edhe pse iu dha mundësia që të paraqitej në seancë (shihni paragrafin 49 më sipër).

106. Gjykata ka vendosur se rivendosja në afat për ankim kundër një dënimi *in absentia*, ku i pandehuri kishte të drejtë të merrte pjesë në seancën dëgjimore në gjykatën e apelit dhe të kërkonte pranimin e provave të reja, nënkuptonte mundësinë e një vendimmarrjeje të re faktike dhe ligjore të akuzës penale, në mënyrë që të mund të thuhet që proceset në tërësi kanë qenë të drejta (shihni *Sejdovic*, cituar më sipër, § 85). Kërkuesi kishte të drejtë të ishte i pranishëm në seancën dëgjimore para Gjykatës së Apelit Vlorë, gjë që do t'i kishte mundësuar atij ndërhyrje në seancë dhe, në veçanti, t'u paraqiste gjykatave të brendshme versionin e tij të ngjarjeve që çuan në akuzat kundër tij dhe të kërkonte pranimin e provave të reja, por ai nuk shfrytëzoi asnjë nga këto mundësi (shihni *Sejdovic*, cituar më sipër, § 85, dhe krahasoni *Jones kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 30900/02, 9 shtator 2003). Për më tepër, në atë fazë të procesit ai ishte ndihmuar nga një avokat i zgjedhur prej tij dhe duhej të kishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme se cilat do të ishin pasojat e sjelljes së tij (krahasoni *Dembukov kundër Bullgarisë*, nr. 68020/01, § 57, 28 shkurt 2008).

107. Kërkuesi nuk ka pretenduar para Gjykatës se nuk ishte qenë në gjendje të paraqiste versionin e tij të fakteve ose interpretimin e tij të dispozitave ligjore përkatëse para gjykatave (krahasoni *Correia de Matos kundër Portugalisë* [DHM], nr. 56402/12, § 163, 4 prill 2018). Sidoqoftë, ai pati mundësinë të bënte, dhe bëri, parashtrime të hollësishme me shkrim në apel (krahasoni *Mulosmani kundër Shqipërisë*, nr. 29864/03, § 129, 8 tetor 2013).

108. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk i shfrytëzoi plotësisht të gjitha mjetet që i jepte legjislacioni i brendshëm. Prandaj, ai është përgjegjës për situatën për të cilën ankohet, pas rihapjes së procesit (krahasoni *Tsalkitzis kundër Greqisë* (nr. 2), nr. 72624/10, § 59, 19 tetor 2017).

109. Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme që Gjykata të arrijë në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) në lidhje me të drejtën e kërkuetit për të marrë pjesë në procese penale kundër tij dhe për t'u mbrojtur personalisht.

ii) E drejta e kërkuetit për të marrë në pyetje dëshmitarin e akuzës

110. Kërkuesi u ankua se as ai dhe as avokati i tij nuk kishin pasur mundësi të pyesnin dy dëshmitarë, R. B. dhe B. H., në asnjë fazë të procesit. Gjykata i komunikoi Qeverisë vetëm pyetje në lidhje me ankimet për këta dy dëshmitarë dhe për këtë arsye do ta kufizojë analizën e saj në dëshmitë e dhëna nga këta dy dëshmitarë.

111. Këta dëshmitarë dhanë dëshminë e tyre para policisë gjyqësore dhe nuk u paraqitën në procesin gjyqësor ndaj kërkuetit në shkallën e parë. Gjykata e Apelit Vlorë refuzoi kërkesën e tij që këta dëshmitarë të thirreshin përsëri në mënyrë që të mund të merreshin në pyetje nga mbrojtja.

112. Deklarimi që R. B. i kishte dhënë policisë gjatë hetimit u lexua në procesin gjyqësor të 27 marsit 2003 në prani të avokatit të kërkuetit, i cili e kundërshtoi atë (shihni paragrafin 37 më sipër). Deklarimi që B. H. i kishte dhënë policisë gjatë hetimit u lexua gjithashtu në proces gjyqësor, në prani të avokatit të kërkuetit. Gjykata vëren se, megjithëse avokati i kërkuetit fillimisht dha pëlqimin që deklarimi i B. H. para se të zhvillohej procesi gjyqësor të lexohej në një seancë dëgjimore më 8 maj 2003 (shihni paragrafin 38 më sipër), gjë që mund të ishte perceptuar si heqje dorë e kërkuetit nga e drejta për të pyetur atë dëshmitar në gjykatë (shihni *Murtaçalijeva kundër Rusisë* [DHM], nr. 36658/05, §§ 119-20, 18 dhjetor 2018), kishte rrethana që kundërshtonin një qasje të tillë. Gjyqi u zhvillua në mungesë të kërkuetit. Ai më pas apeloj kundër dënimit të tij dhe u ankua në gjykatat e brendshme për faktin që nuk kishte pasur mundësi të pyeste dëshmitarët B. H. dhe R. B., dhe gjithashtu kërkoj që dëshmitë e tyre gjatë fazës së hetimit të shpallëshin të papranueshme (krahasoni *Khavshabova kundër Gjeorgjisë*, nr. 26134/19, § 44, 29 qershor 2023, dhe çështjet e cituara në të). Në këto rrethana, Gjykata konstaton se

kërkuesi nuk hoqi dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për të pyetur ndonjë prej këtyre dy dëshmitarëve.

113. Ankimet e kërkuesit kanë të bëjnë me dënimin e tij për dy vepra penale të ndryshme dhe dy ngjarje të veçanta, përkatësisht atë të vrasjes të mbetur në tentativë më 7 shtator 2000 dhe të vrasjes më 30 dhjetor 2000. Gjykata do të vlerësojë secilin prej këtyre dënimeve veçmas në lidhje me të drejtën e kërkuesit për gjykim të drejtë.

α) Dënim për vrasjen e I. N.

- *Nëse ka pasur arsye të forta për mospjesëmarrjen e dëshmitarit R. B. në gjykim*

114. Një gjykatë e shkallës së parë duhet të ketë arsye të forta faktike ose ligjore për të mos siguruar pjesëmarrjen e një dëshmitari në gjyq. Nëse ka arsye të fortë për mosparaqitjen e dëshmitarit, rrjedh se ka arsye të fortë që gjykata e shkallës së parë të pranojë si provë deklaratimet e paverifikuara të dëshmitarit në mungesë (shihni *Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 119). Ka një numër arsyesh pse një dëshmitar mund të mos marrë pjesë në gjyq, duke përfshirë situatat kur ai ose ajo nuk mund të gjendet (shihni *Tseber kundër Republikës Çeke*, nr. 46203/08, § 48, 22 nëntor 2012; *Paić kundër Kroacisë*, nr. 47082/12, § 34, 29 mars 2016; dhe *Asani kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 27962/10, § 44, 1 shkurt 2018).

115. Nevoja që autoritetet të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar pjesëmarrjen e dëshmitarit në gjyq nënkupton më tej shqyrtim të kujdesshëm nga gjykatat e brendshme të arsyeve të dhëna për pamundësinë e dëshmitarit për të marrë pjesë në gjyq, duke pasur parasysh situatën specifike të secilit dëshmitar (shihni *Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 122).

116. Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Vlorë u përpoq pa sukses t'i dorëzonte një fletëthirrje dëshmitarit R. B. në disa raste. Gjithashtu urdhëroi që ai të sillej në gjykatë nga policia gjyqësore. Megjithatë, rezultoi që ai ishte jashtë vendit, megjithëse nuk dihej vendndodhja e tij (shihni paragrafët 36 dhe 37 më sipër). Gjykata ka deklaruar vazhdimisht se largimi jashtë shtetit nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për mungesën e një dëshmitari në gjyq (shihni *Paić*, cituar më sipër, § 38; *Gabrielian kundër Armenisë*, nr. 8088/05, § 78, 10 prill 2012; dhe *Al Alo kundër Sllovakisë*, nr. 32084/19, §§ 48-52, 10 shkurt 2022). Megjithatë, në çështjen konkrete autoritetet bënë përpjekje për të gjetur R. B., por nuk mundën të zbulonin vendndodhjen e tij (krahasoni *Tseber*, cituar më sipër, §§ 50 dhe 51; dhe krahasoni *Okropirizze*, cituar më sipër, § 85; *Khavshabova*, cituar më sipër, § 46; dhe *Asani*, cituar më sipër, § 45).

117. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se kishte arsye të forta për mospjesëmarrjen e dëshmitarit R. B. në procesin gjyqësor të kërkuesit.

- *Nëse deklarimi i dëshmitarit në mungesë ishin baza e vetme apo vendimtare për dënimin e kërkuesit*

118. Gjykata vëren se, duke pretenduar shkelje të të drejtës së tij për të pyetur dëshmitarin R. B., kërkuesi kishte kritikuar mjaft gjatë mënyrën se si gjykatat e brendshme kishin dalë në gjetjet e tyre të faktit dhe në përfundimin e tyre se deklarimi mbështeste gjetjen që ai ishte fajtor për vrasjen e I. N.

119. Gjykata përsërit se nuk e ka për detyrë të merret me gabimet e pretenduara të ligjit ose të faktit të kryera nga gjykatat e brendshme, përveçse nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa, për shembull kur mund të thuhet se ato përbëjnë “padrejtësi” në shkelje të nenit 6 të Konventës. Ndonëse neni 6 garanton të drejtën për një seancë të drejtë dëgjimore, ai nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e deklaratimeve ose mënyrën se si duhet të vlerësohen dëshmitë, ndërsa këto janë kryesisht çështje që duhen rregulluar nga legjislacioni kombëtar dhe gjykatat e brendshme. Në parim, çështje të tilla si pesha që gjykatat e brendshme u japin provave të veçanta ose gjetjeve ose vlerësimeve që u paraqiten atyre për shqyrtim nuk janë çështje për vlerësim nga Gjykata (shihni, *mutatis mutandis*, *De Tommaso kundër Italisë* [DHM], nr. 43395/09, § 170, 23 shkurt 2017). Një gabim i ligjit ose faktit nga gjykatat e brendshme, i cili është aq i dukshëm saqë mund të karakterizohet si një “gabim i dukshëm” - domethënë, një gabim që asnjë gjykatë e zakonshme nuk

mund ta kishte bërë kurrë - mund të jetë i tillë që të prishë drejtësinë e procesit (shihni *Bochan kundër Ukrainës* (nr. 2) [DHM], nr. 22251/08, § 62, GJEDNJ 2015).

120. Në veçanti, nuk i takon Gjykatës që të vendosë për fajësinë ose pafajësinë e kërkuesit. Kjo i takon gjykatave të brendshme. Gjykata ka vetëm rol mbikëqyrës, për të vlerësuar nëse janë respektuar të drejtat procedurale të mbrojtjes dhe, në këtë drejtim, për të vlerësuar nëse proceset në tërësi kanë qenë të drejta (krahasoni *Ajdarić kundër Kroacisë*, nr. 20883/09, § 32, 13 dhjetor 2011; *Van Kück kundër Gjermanisë*, nr. 35968/97, § 47, GJEDNJ 2003 VII; shihni edhe *Ballıktaş Bingöllü kundër Turqisë*, nr. 76730/12, § 78, 22 qershor 2021).

121. Gjatë përcaktimit të peshës së deklaramit të dhënë nga një dëshmitar në mungesë dhe në veçanti nëse dëshmia e dhënë prej tij ose saj është baza e vetme ose vendimtare për dënimin e një kërkuesi, Gjykata merr parasysh, në radhë të parë, vlerësimin e gjykatës së brendshme. Gjykata duhet të bëjë vlerësimin e saj të peshës së deklaramit të dhënë nga një dëshmitar në mungesë vetëm nëse gjykatat e brendshme nuk kanë treguar qëndrimin e tyre mbi atë çështje ose nëse qëndrimi i tyre nuk është i qartë (*Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 124).

122. Dëshmitari R. B. në deklaramin e tij para policisë gjyqësore më 31 dhjetor 2000 u shpreh se kërkuesi i kishte thënë që I. N. i kishte vrarë vëllanë dhe se ai do të hakmerrej për vdekjen e vëllait të tij dhe do ta vriste I. N. pavarësisht pasojave. Ai tha gjithashtu se kërkuesi i kishte thënë se kishte tentuar të vriste I. N. më 7 shtator 2000. Ai tha më tej se më 30 dhjetor 2000, kërkuesi dhe shoku i tij Shuaipi kishin marrë hua makinën e tij, R. B., “për të mbaruar ca punë” në Vlorë, dhe se policia më vonë kishte ardhur në shtëpinë e tij dhe i kishte thënë që makina e tij ishte përdorur për vrasjen e I. N.

123. Gjykata fillimisht vëren se Gjykata e Rrethit Vlorë nuk deklaroi shprehimisht që deklarimi i dëshmitarit R. B. gjatë fazës së hetimit ishte prova e vetme kundër kërkuesit në lidhje me akuzën e vrasjes së I. N. Prandaj, pyetja është nëse gjykata e konsideroi dëshminë si vendimtare, domethënë, dëshmi me rëndësi ose domethënie të tillë që ka të ngjarë të jetë përcaktuese për rezultatin e çështjes. Gjykata e Rrethit Vlorë e trajtoi deklaramin e R. B. të dhënë gjatë fazës së hetimit vetëm si provë mbështetëse, pasi ajo lidhej me marrjen hua të makinës së R. B. nga kërkuesi dhe D. Zh. disa orë para vrasjes së I. N. dhe përdorimin e pretenduar të saj nga kërkuesi për të shkuar me makinë në vendngjarje dhe për t’u larguar prej andej. Megjithatë, Gjykata e Rrethit Vlorë nuk mbajti shprehimisht një qëndrim të qartë në lidhje me peshën e dëshmisë së R. B. (krahasoni *Strassenmeyer kundër Gjermanisë*, nr. 57818/18, § 77, 2 maj 2023).

124. Gjykata, në vlerësimin e saj nëse deklarimet e pa verifikuara ishin vendimtare për dënimin e kërkuesit, do të marrë në konsideratë fuqinë e provave mbështetëse: sa më të forta të jenë provat mbështetëse, aq më pak ka të ngjarë që dëshmia e dëshmitarit në mungesë të trajtohet si vendimtare (shihni *Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 123).

125. Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Vlorë përcaktoi motivin e kërkuesit nga deklarimet e dëshmitarëve të ndryshëm të cilët thanë se familja Jaupi kishte fajësuar I. N. për vdekjen e vëllait të kërkuesit, I. J. Në veçanti, Gjykata e Rrethit Vlorë i dha peshë të konsiderueshme dëshmisë së mamasë së kërkuesit, e cila tha se I. N. kishte qenë përgjegjës për vdekjen e djalit të saj, I. J. dhe se I. N. duhej të vritej, dhe se kjo kishte qenë arsyeja pse djali i saj tjetër, kërkuesi, kishte filluar të “ngatërrohej” me I. N.

126. Lidhur me vrasjen e I. N., Gjykata e Rrethit Vlorë kishte para saj shumë prova, përkatësisht raportin e vendngjarjes, procesverbalin e këqyrjes së trupit të viktimës, raportin e autopsisë, raportet e ekspertimit balistik dhe kriminalistik me fotografi, dhe deklarimet e dhëna nga dëshmitarët A. J., E. Ll., B. T., A.L., E.B., A.Ç., B. M., Sh. O., S. M. dhe Th. N., si dhe njohjen e kërkuesit dhe D. Zh. nga fotografitë.

Provat përfshinin deklaratimet e dy dëshmitarëve okularë, njëri prej të cilëve ishte polic jashtë shërbimit (B. T.) i cili e kishte njohur bashkëpunëtorin e kërkuesit si personin që kishte qëlluar I. N., si dhe A.Ç., i cili e kishte identifikuar kërkuesin si personin që e kishte parë duke ikur nga vendi i ngjarjes, ndërsa ecte me armë në dorë (shihni paragrafët 15, 25 dhe 35 më sipër). Provat përfshinin gjithashtu informacionin në lidhje me gjakmarrjen e dyshuar ndërmjet kërkuesit dhe viktimës, e cila u raportua nga dëshmitarë të ndryshëm, përfshirë anëtarë të familjes së kërkuesit dhe viktimës. Ato përfshinin gjithashtu, ndër të tjera, dëshminë që kërkuesi kishte udhëtuar nga qyteti i tij i lindjes në Vlorë ditën e ngjarjes, si dhe dëshminë e një dëshmitari tjetër që kishte strehuar kërkuesin dhe bashkëpunëtorin e tij në afërsi të Vlorës ditën e vrasjes, ndërsa policia ishte në kërkim të autorëve të krimit. Kjo u konfirmua nga disa dëshmitarë të tjerë që kishin parë kërkuesin dhe bashkëpunëtorin e tij në shtëpinë në Levan në të njëjtën periudhë. Deklarimi i dëshmitarit R. B. e lidhi kërkuesin me D. Zh. ditën e vrasjes, por ai nuk ishte e vetmja provë për këtë lidhje.

127. Lidhur me parimin që kërkohet një interpretim i ngushtë i termit “vendimtar” (shihni *Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 123, shihni edhe paragrafin 99 më sipër), Gjykata del në përfundimin se deklarimi i dëshmitarit në fazën e hetimit nuk ishte vendimtar në çështjen në fjalë. Gjithashtu ai nuk mbartte ndonjë peshë të konsiderueshme për ta shpallur kërkuesin fajtor për vrasjen e I. N.

128. Gjykata gjithashtu konstaton se nuk kishte asgjë arbitrare në arsyetimin e gjykatave të brendshme ose në vlerësimin e tyre të provave që çuan në shpalljen e kërkuesit fajtor për pjesëmarrje në vrasjen e I. N., gjë që mund të përbënte shkelje të nenit 6 të Konventës.

- *Konkluzion*

129. Duke pasur parasysh se kishte arsye të forta për mosparaqitjen e dëshmitarit R. B. në procesin gjyqësor të kërkuesit, dhe, në veçanti, se deklarimi i R.B në fazën e hetimit nuk ishte as prova e vetme dhe as prova vendimtare për shpalljen fajtor të kërkuesit për vrasjen e I. N. dhe për më tepër se nuk kishte peshë të konsiderueshme në këtë drejtim, Gjykata gjen se të drejtat e kërkuesit për mbrojtje nuk ishin të kufizuara në një masë të papajtueshme me garancitë e ofruara nga neni 6 i Konventës (krahasoni *Kostecki kundër Polonisë*, nr. 14932/09, § 72, 4 qershor 2013; *Dimović dhe të tjerë kundër Serbisë*, nr. 7203/12, §§ 59 dhe 64, 11 dhjetor 2018; *Fafrowitz kundër Polonisë*, nr. 43609/07, § 63, 17 prill 2012; dhe *Mika kundër Suedisë* (vendim), nr. 31243/06, §42, 27 janar 2009). Në këto rrethana, ajo nuk gjen shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës për pamundësinë e kërkuesit për të marrë në pyetje R. B.

β) Dënimi për vrasjen e mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J.

130. Gjykata thekson se dëshmitari B. H kishte dhënë deklarinë e tij në polici gjatë hetimit. Ai nuk u paraqit në procesin gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Vlorë.

- *Nëse kishte arsye të forta për mospjesëmarrjen e dëshmitarit B. H në gjykim*

131. Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Vlorë u përpoq pa sukses t'i dorëzonte fletëthirrjen dëshmitarit B. H. në disa raste. Gjithashtu urdhëroi që ai sillej në gjykatë nga policia gjyqësore. Megjithatë, rezultoi që ai ishte jashtë shtetit, megjithëse nuk dihej vendndodhja e tij (shihni paragrafin 32 më sipër). Autoritetet bënë përpjekje për të lokalizuar B. H, por nuk mund të zbulonin vendndodhjen e tij.

132. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se kishte arsye të forta për mospjesëmarrjen e dëshmitarit B. H. në procesin gjyqësor të kërkuesit.

- *Nëse deklarimi i dëshmitarëve në mungesë ishin baza e vetme apo vendimtare për dënimin e kërkuesit*

133. Gjykata vëren se gjykatat e brendshme gjithashtu u mbështetën në dëshmitë e kontestuara të dhëna nga dëshmitarët në mungesë B. H. dhe R. B. para policisë gjyqësore gjatë fazës së hetimit për dënimin e kërkuesit për vrasje të mbetur në tentativë (ngjarja e 7 shtatorit 2000). Në deklarinë e tij, B. H. u shpreh për një rrëfim të pretenduar të krimit nga kërkuesi kur të dy ishin në Greqi. R. B. i tha

gjithashtu policisë se në një rast në Tiranë, kërkuesi i kishte thënë se kishte tentuar të vriste I. N. më 7 shtator 2000.

134. Përveç dëshmime të dhëna nga B. H. dhe R. B. rreth ngjarjeve të 7 shtatorit 2000, vetë viktimat i kishte raportuar gjithashtu policisë dyshimin e tij se personi që kishte qëlluar mbi të më 7 shtator 2000 me qëllim vrasjen e tij ishte kërkuesi, megjithëse ai nuk kishte dijeni të drejtpërdrejtë se kush ishte autori i krimit sepse nuk e kishte parë. Po kështu, Th. N. në deklarin e tij ishte shprehur që djali i tij, I. N. i kishte thënë të njëjtën gjë. Megjithatë, të gjitha këto dëshmi u dhanë gjatë hetimit policor dhe jo në proces gjyqësor. Gjithashtu, asnjë nga këta dëshmitarë nuk kishte dijeni të drejtpërdrejtë për identitetin e autorit të krimit.

135. Është e rëndësishme që, dhe ndryshe nga qëndrimi për dënimin për vrasjen, Gjykata gjen se deklarinet e B. H. dhe R. B. gjatë hetimit ishin “vendimtare” për dënimin e kërkuesit për vrasjen e mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J., duke pasur parasysh që provat e mbetura kishin të bënin kryesisht me motivin e mundshëm të kërkuesit dhe jo me lidhjen e tij me tentativë në fjalë ndaj jetës së I. N.

136. Për të vlerësuar drejtësinë e përgjithshme të procesit, Gjykata do të vlerësojë ekzistencën e faktorëve të mjaftueshëm kundërbalancues (shihni *Schatschaschwili*, të cituar më sipër, § 116).

- *Nëse kishte faktorë të mjaftueshëm që të kundërbalancin disavantazhin e mbrojtjes*

137. Gjykata theksoi se kur një deklarin i bërë jashtë gjykate është prova e vetme ose vendimtare kundër një të pandehuri, pranimi i tij si provë nuk do të rezultojë automatikisht në shkelje të nenit 6 § 1. Në të njëjtën kohë, kur një dënim bazohet vetëm ose përfundimisht në deklarinet e dëshmitarëve në mungesë, Gjykata duhet të zhvillojë proceset me kujdesin më të madh. Për shkak të rreziqeve të pranimit të këtyre dëshmimeve, kjo do të përbente një faktor shumë të rëndësishëm për balancim dhe do të kërkonte faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë ekzistencën e garancive të forta procedurale. Pyetja në secilin rast është nëse ekzistojnë faktorë të mjaftueshëm kundërbalancues, duke përfshirë masat që lejojnë një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së atyre dëshmimeve. Kjo do të lejonte që dënimi të bazohej në këto dëshmi vetëm nëse ato janë mjaftueshëm të besueshme duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për çështjen shihni *Al-Khawaja dhe Tahery*, cituar më sipër, § 147).

138. Sa i përket ekzistencës së ndonjë faktori kundërbalancues që mund të kompensojë pengesat e shkaktuara nga pamundësia e kërkuesit për të kundërshtuar dëshmitarët e akuzës dhe për t'i pyetur ata personalisht para gjykatës së shkallës së parë, Gjykata vëren se elementët e mëposhtëm janë identifikuar si të rëndësishëm në këtë kontekst: qasja e gjykatës së shkallës së parë ndaj deklarinave të paverifikuara; disponueshmëria dhe fuqia e provave të mëtejshme fajësuese; dhe masat procedurale të marra për të kompensuar pamundësinë për të pyetur dëshmitarët drejtpërdrejt në gjyq (shihni *Schatschaschwili*, i cituar më sipër, §§ 125 31 dhe 145).

- *Qasja e gjykatave të brendshme ndaj deklarinave të paverifikuara*

139. Në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë nuk ka asnjë të dhënë që ato t'i kenë trajtuar deklarinet e B. H. dhe R. B. me ndonjë kujdes specifik ose që t'u kenë dhënë më pak peshë deklarinave të tyre meqë nuk morën pjesë në gjykim (krahasoni, për shembull, *Al Khawaja dhe Tahery*, cituar më sipër, § 157, dhe *Bobes kundër Rumanisë*, nr. 29752/05, § 46, 9 korrik 2013). Përkundrazi, ato e bazuan dënimin e kërkuesit për vrasje të mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J. kryesisht në deklarinet e B. H. dhe R. B. pa vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarëve ose besueshmërinë e dëshmisë së tyre (krahasoni *Schatschaschwili*, cituar më sipër, §§ 148 50; krahasoni *Brzuszczyński kundër Polonisë*, nr. 23789/09, §§ 86 dhe 89, 17 shtator 2013; *Präjină kundër Rumanisë*, nr. 5592/05, § 59, 7 janar 2014; dhe *Nikolitsas kundër Greqisë*, nr. 63117/09, § 37, 3 korrik 2014).

140. Gjithashtu, asnjë nga gjykatat e brendshme nuk trajtoi linjën e argumentit të kërkuesit që edhe R. B. edhe B. H. kishin thënë se kërkuesi u kishte thënë atyre që kishte qëlluar ndaj I. N., dhe se bisedat e supozuara me R. B. dhe B. H. u raportuan sikur kjo kishin ndodhur afërsisht në të njëjtën kohë, edhe

pse biseda me R. B. dyshohet se ka ndodhur në Shqipëri dhe biseda me B. H. dyshohet se ka ndodhur në Athinë, Greqi. Kërkuesi pretendoi se ai nuk mund të kishte qenë në dy vende në të njëjtën kohë.

- *Disponueshmëria dhe fuqia e provave të tjera të akuzës*

141. Siç u përmend më sipër, e vetmja provë mbështetëse përbëhej nga deklaratimet e dhëna nga I. N. dhe babai i tij, Th. N., ku të dy shprehnin dyshimin e thjeshtë që personi që kishte tentuar të vriste I. N. më 7 shtator 2000 kishte qenë kërkuesi.

142. Për më tepër, asnjë nga këta dëshmitarë nuk dëshmoi në gjyq, I. N. për një arsye të qartë, sepse kishte vdekur, dhe Th. N. sepse po merrte trajtim mjekësor jashtë vendit.

143. Edhe pse mamaja e kërkuesit, L. J., tha para gjykatës së shkallës së parë se I. N. duhej të vritej sepse për familjen Jaupi, ai kishte qenë përgjegjës për vdekjen e djalit tjetër të saj, I. J., dhe se për shkak të kësaj kërkuesi kishte filluar të “ngatërrohej” me I. N., ajo nuk iu referua në asnjë mënyrë ngjarjeve të 7 shtatorit 2000.

- *Masa procedurale*

144. Gjykata përsëriti se një deklaratim dëshmitari i marrë nga policia gjyqësore nuk mund të konsiderohet si zëvendësues i të drejtës së kërkuesit për ta pyetur atë dëshmitar në prani të gjyqtarit të shkallës së parë, i cili në fund do të gjykojë për çështjen e fajësisë së tij ose të saj (shihni *Schatschaschwili*, cituar më sipër, § 155; shihni edhe *Hümmer kundër Gjermanisë*, nr. 26171/07, § 48, 19 korrik 2012; *Hanu kundër Rumanisë*, nr. 10890/04, § 40, 4 qershor 2013 *in fine*; dhe *Dadayan kundër Armenisë*, nr. 14078/12, § 46, 6 shtator 2018; shihni edhe, *mutatis mutandis*, *Faysal Pamuk kundër Turqisë*, nr. 430/13, §§ 70-71, 18 janar 2022).

145. Sa u përket masave procedurale që synojnë kompensimin e mungesës së mundësisë që mbrojtja të marrë në pyetje drejtpërdrejt dëshmitarët në gjyq, Gjykata thekson se B. H. dhe R. B. kishin dhënë deklaratimet e tyre në policinë gjyqësore në mungesë të palëve. Kërkuesi nuk kishte mundësi të kundërshtonte deklaratimet në atë kohë, dhe as B. H. dhe as R. B. nuk morën pjesë në gjyq.

146. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e brendshme nuk mund të shihnin një regjistrim video të B. H. dhe R. B. duke dhënë deklaratimet e tyre në polici, sepse nuk ishte bërë një regjistrim i tillë. Siç është vërejtur në *Schatschaschwili* (cituar më sipër, § 127), gjykatat e shkallës së parë në sisteme të ndryshme ligjore e përdorin këtë praktikë, e cila u lejon atyre, si mbrojtjes ashtu edhe akuzës, të vëzhgojnë sjelljen e një dëshmitari gjatë marrjes në pyetje dhe të krijojnë një përshtypje më të qartë për besueshmërinë e dëshmitarit. As kërkuesi as gjyqtarët nuk e kishin këtë mundësi në çështjen konkrete (shihni, për shembull, *Blokhin kundër Rusisë* [DHM], nr. 47152/06, § 215, 23 mars 2016; *Chernika kundër Ukrainës*, nr. 53791/11, § 73, 12 mars 2020; dhe *Khavshabova*, cituar më sipër, § 55).

- *Konkluzion*

147. Vlerësimet e mësipërme janë të mjaftueshme që Gjykata të dalë në përfundimin që është shkelur neni 6 §§ 1 dhe 3 (d) i Konventës në lidhje me dënimin e kërkuesit për vrasjen e mbetur në tentativë të I. N. dhe A. J.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

148. Neni 41 i Konventës lexon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

A. Dëmi

149. Kërkuesi pretendoi shumën 7000 euro (EUR) për dëmin jopasuror.

150. Qeveria pretendoi se kërkuesi nuk kishte pësuar dëm dhe në rast se Gjykata do të gjente shkelje të nenit 6 të Konventës, kjo gjetje do të përbënte shpërblim mjaftueshëm të drejtë.

151. Gjykata nuk mund të spekulojë se si do të ishte rezultati i procesit kundër kërkuesit nëse nuk do të kishte shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës. Gjykata vlerëson se gjetja e shkeljes përbën shpërblim mjaftueshëm të drejtë në këtë çështje. Prandaj ajo refuzon pretendimin për dëmin jopasuror.

B. Kosto dhe shpenzime

152. Kërkuesi gjithashtu pretendoi 3810 euro për kosto dhe shpenzime të bëra në gjykatat e brendshme dhe në Gjykatë.

153. Qeveria pretendoi se kostot dhe shpenzimet e bëra në proceset e brendshme i ishin dhënë kërkuesit nga gjykatat e brendshme dhe se pretendimi për kosto dhe shpenzime në proceset përpara Gjykatës ishte i pajustificuar.

154. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, një kërkues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për atë që sa provohet se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme sa i përket shumës. Në këtë çështje, duke pasur parasysh dokumentet përpara saj dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që t'i caktojë kërkuesit shumën prej 1200 EUR për të mbuluar kostot dhe shpenzimet për proceset në Gjykatë, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *shpall* të pranueshme ankimet sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d) në lidhje me të drejtën e kërkuesit për të marrë pjesë në procesin penal kundër tij dhe për të pyetur dëshmitarët e akuzës R. B. dhe B. H. dhe të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

2. *vendos* që nuk është shkelur neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) i Konventës në lidhje me të drejtën e kërkuesit për të marrë pjesë në procesin penal kundër tij;

3. *vendos* që nuk është shkelur neni 6 §§ 1 dhe 3 (d) i Konventës në lidhje me të drejtën e kërkuesit për të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës për dënimin e tij për vrasje;

4. *vendos* që është shkelur neni 6 §§ 1 dhe 3 (d) i Konventës në lidhje me të drejtën e kërkuesit për të marrë në pyetje dëshmitarët e akuzës R.B dhe B. H për dënimin e tij për vrasje të mbetur në tentativë;

5. *vendos* që gjetja e shkeljes përbën në vetvete shpërblim mjaftueshëm të drejtë për çdo dëm jo monetar të pësuar nga kërkuesi;

6. *Vendos*:

a) që Shteti i paditur t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 44 të Konventës, shumën 1200 (një mijë e dyqind) euro plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit që do të konvertohet në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes;

b) që nga mbarimi i afatit tre mujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, të paguhet interes i thjeshtë për shumën e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;

7. *rrëzohet* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesit për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 29 prill 2025 sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
Zëvendëskancelare

Ioannis Ktistakis
Kryetar